



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS

2021

Prill, 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2021

Prishtinë, prill 2022

Përmbajtja

FJALORI I SHPREHJEVE.....	3
FJALA E AUDITORES SË PËRGJITHSHME.....	4
VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE PËR VITIN 2021	7
Baza e Raportit të Performancës.....	9
Kapitull I:Korniza ligjore dhe Qeverisja e Brendshme	11
1.Pavarësia dhe Korniza ligjore	12
1.1.Pavarësia institucionale.....	12
1.2.Mandati	13
2.Qeverisja e brendshme dhe etika.....	14
2.1.Planifikimi strategjik dhe operativ	14
2.2.Mjedisi i kontrollit organizativ	16
2.3.Komunikimi i brendshëm	17
Kapitulli II:Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit	
dhe Raportimi.....	19
1.Cilësia e auditimit dhe raportimi	20
2.Auditimet e realizuara dhe të planifikuara	22
3.Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve të auditimit	
(financiar dhe të pajtueshmërisë).....	26
4.Auditimet e performancës.....	29
5.Kontrolli i cilësisë	42
Kapitulli III:Menaxhimi Financiar dhe Administrativ	45
1.Menaxhimi financiar.....	46
2.Pasuritë	51
3.Burimet Njerëzore.....	51
4.Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit.....	54
5.Mirëqenia e personelit	56
6.Shërbimet e përbashkëta	56
7.Teknologjia informative	57
8.Prokurimi.....	57
Kapitulli IV:Komunikimi dhe Bashkëpunimi me	
Palët e jashtme	59
1.Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit.....	60
2.Komunikimi me mediat, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile,	
donatorët dhe palët të tjerë	63
3.Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere dhe Marrëveshjet	
Bilaterale	65
Kapitulli V:Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2022	69
1.Llogaridhënia e ZKA-s dhe sfidat.....	70
2.Aktivitetet gjatë viti 2022	70
Shtojca I. AUDITIMET PËR SEZONIN 2020/21 DHE 2021/22.....	72
Shtojca II. PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZKA-SË PËR VITIN 2021	76

FJALORI I SHPREHJEVE

AB	Auditori i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
BE	Bashkimi Evropian
BK	Buxheti i Kosovës
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA)
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KIDP	Korniza e INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale
KBT	Komisioni për Buxhet dhe Transfere
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
NP	Ndërmarrje Publike
OB	Organizata Buxhetore
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore RVPR
RVP	Raporti Vjetor i Performancës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
RFV/BK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNAO	Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SITA	Sistemin Informativ i Teknologjisë së Auditimit
TI	Teknologjia Informative
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

FJALA E AUDITORES SË PËRGJITHSHME

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,



Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin Vjetor të Performancës, për vitin 2021 siç përcaktohet në nenin 138 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i përforcuar më tej me nenin 14 të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë vitit 2021, ka zbatuar Planin Strategjik 2018-2021 duke u fokusuar në përmbushjen e misionit

kushtetues e ligjor, zhvillimin e kapaciteteve profesionale si dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve të mira me palët e jashtme. Aktiviteti auditues është mbështetur në Planin Vjetor të Auditimit 2020/21, që paraprakisht i është dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pavarësisht sfidave me pandeminë COVID 19, institucioni ka arritur të përmbushë objektivat institucionale në afat ligjor duke audituar fusha me interes për Kuvendin dhe qytetarët.

Gjatë vitit 2021, kemi kryer auditimin e Raportit Vjetor Financiar, përfshirë evidencat përkatëse të buxhetit të shtetit për vitin 2020, i cili është mbështetur nga auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë të të gjitha organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, kemi kryer auditimet e performancës, prokurimit publik dhe të teknologjisë së informacionit, si dhe auditimet e projekteve të financuara nga fondet e donatorëve. Për herë të parë në 2021 janë kryer auditimet e veçanta të pajtueshmërisë dhe po ashtu janë audituar informata të klasifikuara me ligj.

Auditimet kanë rezultuar me një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve për përmirësimin e menaxhimit të financave publike, dhe shfrytëzimin e fondeve publike me efikasitet, efektivitet dhe arritjen e vlerës për para.

Përveç kësaj, kemi avancuar metodologjinë për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë, digjitalizimin e punës audituese, duke shtuar dhe përsosur me mundësi të reja sistemin elektronik të auditimit.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, në vitin 2021 është përmbyllur projekti i binjakëzimit me Institucionin Suprem të Auditimit të Polonisë, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian. Po ashtu, ka vazhduar bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë në fusha të ndryshme të zhvillimit institucional, me theks në fushën e auditimit të performancës.

Për të rritur përgjegjshmërinë në sektorin publik, kemi dërguar 52 raste me elemente potenciale të veprave penale, mashtrimit dhe korrupsionit në Prokurori të Shtetit si dhe kemi ofruar informacione për rastet të natyrës së tillë.

I jam mirënjohëse Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike për shqyrtimin e raporteve të auditimit dhe Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere për mbështetjen financiare të institucionit tonë. Bashkëpunimi më këto Komisione ka qenë i rëndësishëm për adresimin, jo vetëm të rezultateve të ZKA-së, por edhe të sfidave të cilat e kanë përcjellë Zyrën për çka ju shpreh falënderimin tim të sinqertë.

Për përmbushjen e Planit vjetor të auditimit për 2021 dhe rezultatet e arritura, e vlerësoj lartë kontributin e të gjithë stafit tim për punën e palodhur dhe përkushtimin në kryerjen e mandatit kushtetues.

Për vëmendjen tuaj, mandatin për ta drejtuar këtë institucion e kam pranuar me datë 12 gusht 2021, deri në këtë kohë, Zyrën Kombëtare të Auditimit e ka udhëhequr Auditori i mëparshëm.

Dhe krejt në fund, dua ta theksoj përkushtimin tim, që ta avancoj më tutje kompetencën profesionale të Zyrës Kombëtare të Auditimit, ruaj pavarësinë institucionale, forcojë integritetin, transparencën dhe frymën ekipore me qëllimin e vetëm që t'i ofrojë Kuvendit dhe qytetarëve informacion objektiv dhe relevant për shpenzimin e parasë publike.

Me respekt,

Vlora Spanca
Auditore e Përajtshme



Prishtinë, prill 2022

VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

Vizioni

Institucion që rrit përgjegjshmërinë dhe transparencën në përdorimin e burimeve publike dhe promovon qeverisjen e mirë.

Vlerat e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

- **Pavarësia**

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.

- **Profesionalizmi**

ZKA udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të ONISA/INTOSAI dhe nga praktikat më të mira të vendeve.

- **Integriteti**

ZKA angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.

- **Transparenca**

ZKA është organizatë e hapur dhe do t'i bëj publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofroj publikut të gjerë informacionin e përftuar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA angazhohet që të promovoj transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

- **Fryma ekipore**

Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunues në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.

Misioni

Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe rritjen e llogaridhënies publike.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE PËR VITIN 2021

Rezultatet e punës audituese për vitin 2021

Auditimet Financiare dhe të Pajtushmërisë - Për vitin 2021, janë kryer 116 auditime të pasqyrave vjetore financiare, objektivë e së cilave ishte të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit dhe për të cilat kemi shprehur opinionin e auditimit. Përveç, opinionit të auditimit po ashtu kemi shprehur konkluzionin e auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Këto auditime kanë përfshirë auditimin e pasqyrave vjetore financiare të organizatave buxhetore përfshirë nivelin qendror, nivelin lokal dhe institucionet e pavarura, ndërmarrjet publike si dhe projektet e financuara nga donatorë siç janë Banka Botërore dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim.

Auditimet e performancës – kanë mbuluar fusha me interes për qytetarët, Kuvendin e Kosovës dhe palët e tjera të interesit. Fokus i auditimeve ishte: zhvillimi ekonomik, mirëqenia sociale, shëndetësia, mjedisi dhe siguria, teknologjia e informacionit si dhe fusha e prokurimit publik.

Përmes këtyre angazhimeve, ZKA ka kryer 13 auditime të performancës përmes së cilave ka promovuar efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin, vlerën për para dhe transparencën e administratës publike. Fokus i veçantë i është dhënë kryerjes së auditimeve për pandeminë COVID 19, më qëllim që t'i ofrojë Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës një informacion lidhur me menaxhimin e pandemisë në Republikën e Kosovës.

Auditimet e veçanta të pajtushmërisë - për herë të parë në vitin 2021, kemi filluar me auditime të veçanta të pajtushmërisë përmes së cilave kemi vlerësuar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Gjatë vitit 2021, janë kryer dy auditime të veçanta të pajtushmërisë një në ndërmarrjen publike KOSTT dhe një tjetër në Ministrinë e Drejtësisë lidhur me shpenzimet për programin për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial nga Dhomat e Specializuara.

Auditimet tona janë kryer në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Çështjet Kryesor nga

Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2021

- cilësinë e raportimit,
- planifikimin dhe realizimin e buxhetit,
- kontrollet e vlefshmërisë së dhënave në SIMFK,
- klasifikimet e shpenzimeve,
- efikasitetin në shpenzimin e fondeve nga borxhet publike,
- menaxhimin e llogarive të arkëtueshme,
- detyrimet e paguara dhe detyrimet kontigjente,
- regjistrimin, prezantimin dhe trajtimin jo adekuat të pasurive,
- raportimi financiar me mangësi theksuar në Ndërmarrje Publike, si dhe
- zbatimin e rekomandimeve.

Zbatimi i rekomandimeve

- ZKA në raportet e auditimit të vitit 2019 kishte dhënë 803 rekomandime dhe gjatë auditimit në vitin 2020 kishte vlerësuar zbatimin e rekomandimeve. Sipas vlerësimeve në (institucione qendrore, të pavarura dhe lokale) ka rezultuar se 45% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 7% pjesërisht ishin zbatuar, 34% nuk janë zbatuar fare, ndërsa 14% janë mbyllur si të pa zbatuara.
- ZKA në raportet e auditimit të vitit 2019 në NP kishte dhënë 244 rekomandime dhe gjatë auditimit në vitin 2020 kishte vlerësuar zbatimin e rekomandimeve dhe sipas vlerësimeve ka rezultuar se 54% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 9% janë në proces të zbatimit, 1% ishin mbyllur të pazbatuara dhe 36% edhe me tutje nuk janë zbatuar.

Menaxhimi financiar dhe administrativ i ZKA-së, për vitin 2021

Gjatë viti 2021, buxheti i Zyrës Kombëtare të Auditimit është shpenzuar në vlerë prej 2,750,000€, apo 99%. Shuma më e madhe e buxhetit shpenzohet në kategorinë e pagave dhe mëditjeve prej 80% dhe mallra dhe shërbime prej 17%. Krahasuar me vitet paraprake, vërehet se kategoria e investimeve kapitale është reduktuar në masë, si rrjedhojë e përfundimit të projektit kapital "Softueri për menaxhimin e proceseve të auditimit (SITA)".

ZKA, në fund të vitit 2021 kishte 164 punonjës. Struktura e personelit ndahet në ekipin menaxhues, auditorët dhe pjesa e punonjësve që ofrojnë shërbime profesionale mbështetëse. Struktura e numrit të përgjithshëm të personelit përbehet prej 82% personel auditues (përfshirë pozitat drejtuese), dhe 18% janë punonjës të shërbimeve të tjera profesionale mbështetëse.

ZKA, i ka kushtuar rëndësi certifikimit dhe edukimit të vazhdueshëm profesional të stafit në hap me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit, auditimit, TI-së, përformancës dhe fusha tjera relevante. Deri sa po raportohet, në skemën e certifikimit publik nëpër nivele janë certifikuar 98 auditorë. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 është investuar edhe në avancimin, monitorimin dhe sigurinë e rrjetit të

teknologjisë informative të ZKA-së, me qëllim që të dhënat tona të jenë të sigurta nga sulmet e mundshme kibernetike apo avaritë tjera eventuale.

Komunikimi me palët e jashtme

Gjatë vitit 2021, ZKA ka pasur një komunikim të frytshëm me Kuvendin dhe palët e interesit, dhe ka zhvilluar më tutje qasjen gjithëpërfshirëse, duke qenë nikoqire dhe pjesëmarrëse në shumë takime, punëtori e konferenca brenda dhe jashtë vendit.

Në rrafshin kombëtar është forcuar më tej partneriteti me komisionet parlamentare dhe organizatat e shoqërisë civile, ndërsa në rrafshin ndërkombëtar është avancuar bashkëpunimi në mes të Institucioneve Supreme të Auditimit përmes takimeve, punëtorive e aktiviteteve të tjera në kuadër të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t.

Baza e Raportit të Performancës


Bazuar në nenin 14 të ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm i dorëzon Kuvendit Raportin Vjetor të Performancës rreth aktiviteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Duhet të theksohet, se për shkak të përfundimit të mandatit të Auditorit paraprak, Kuvendi i Kosovës me 12 gusht të vitit 2021 ka zgjedhur Auditoren e Përgjithshme Znj. Vlora Spanca me mandat 5 vjeçar.

Gjatë ushtrimit të mandatit të saj kushtetues dhe ligjor, ZKA-ja bazohet në strukturën e Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA). Kjo kornizë u ofron ISA-ve mundësinë që të vlerësojnë nivelin e performancës së tyre kundrejt Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Kjo kornizë ka për qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e mëtejshëm në zhvillimin e kapaciteteve të ISA-ve përmes menaxhimit dhe promovimit të matjes së performancës, si dhe identifikimin e mundësive për të forcuar dhe monitoruar performancën dhe llogaridhënien e ISA-ve.

Korniza e Matjes së Performancës së ISA-ve, si dokument standard i INTOSA-it, përmban gjashtë fusha kryesore:



Andaj, edhe raporti vjetor i performancës së ZKA-së është prezantuar i shpalosur dhe radhitur sipas fushave kryesore të kësaj kornize.

Kapitull I

Korniza ligjore dhe Qeverisja e Brendshme

Kapitull I

Korniza ligjore dhe Qeverisja e Brendshme

Pavarësia dhe qeverisja e brendshme në mënyrë të drejtpërdrejtë reflektojnë përmbushjen e mandatit kushtetues e ligjor me qëllim të kryerjes së auditimeve cilësore në përputhje me SNISA.

1. Pavarësia dhe Korniza ligjore

Kjo fushë mbulon mandatin ligjor dhe pavarësinë e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm (AP)¹. Përveç kornizës ligjore të vendit, Kushtetutës dhe ligjeve relevante, bazë e parimeve themelore të ISA-ve për këtë fushë janë: Deklarata e Limës (INTOSAI-P 1, ish-SNISA 1) dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve (INTOSAI-P 10, ish-SNISA 10). Treguesit që ZKA-ja ka aplikuar për këtë fushë janë: pavarësia institucionale dhe mandati.

1.1. Pavarësia institucionale

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton se Auditori i Përgjithshëm është institucioni më i lartë i pavarur i kontrollit ekonomik e financiar në vend. Kompetencat themelore të AP-së janë përcaktuar me Kushtetutë dhe janë definuar më tej me ligjin e veçantë, Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (Ligji i ZKA-së), i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2016. Sipas legjislacionit në fuqi, AP-ja ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij. Ai është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së.

Gjatë vitit 2021, nuk janë shënuar raste të ndonjë ndërhyrjeje nga palët e treta në punën e AP-së dhe se AP dhe Zyra përkatëse ka ushtruar e lirë dhe e pa ndikuar rolin dhe veprimtarinë e sajë.

Ndër parimet bazë të funksionimit të Auditorit të Përgjithshëm janë kushtetutshmëria dhe ligjshmëria. Për zbatimin e këtyre parimeve, është materializuar pavarësia kushtetuese e Auditorit të Përgjithshëm përmes kornizës së brendshme normative, e cila ka marrë dimensione të reja në vitin 2021. Në fakt, Auditori i Përgjithshëm i ka dhënë theks të ri kësaj kornize duke aprovuar strukturën e re organizative.

¹ Në këtë Raport, institucionit të Auditorit të Përgjithshëm do t'i referohemi edhe si Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

Në anën tjetër, edhe Ligji aktual për ZKA-në ka nevojë për ndryshim për sa i përket të drejtës së Qeverisë për të modifikuar kërkesën buxhetore të ZKA-së². Në lidhje me këtë, AP-ja i ka informuar edhe deputetët e Kuvendit edhe anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe ata të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Një ndryshim tjetër i rëndësishëm i këtij ligji ka të bëjë me heqjen e obligimit për auditime të përvitshme të rregullsisë, për të gjitha organizatat buxhetore (pavarësisht madhësisë, kompleksitetit, rrezikut, etj.), i cili krijon një barrë të panevojshme për ZKA-në dhe pamundëson aplikimin e qasjes së përzgjedhjes së auditimeve bazuar në rrezik.

1.2. Mandati

Ky tregues vlerëson autoritetin operacional të ZKA-së, të përcaktuar në Kornizën ligjore. Dimensionet për të vlerësuar këtë tregues janë: mandati i mjaftueshëm dhe i gjerë; qasja në informata; dhe e drejta dhe detyrimi për të raportuar.

Kushtetuta e vendit dhe Ligji i veçantë, i japin AP-së **mandat të gjerë të auditimit** të të gjitha subjekteve të sektorit publik në Kosovë. Megjithatë, disa ligje të veçanta kanë krijuar paqartësi për auditimin e disa institucioneve publike që çështjen e auditimit e kanë trajtuar në mënyrë tjetër krahasuar me dispozitat kushtetuese dhe ato të Ligjit për AP-në³. Për më tepër, Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk është harmonizuar me Kushtetutën, Ligjin për AP-në dhe Ligjin për Ndërmarrjet publike (NP), lidhur me mandatin e AP-së për auditimin e NP-ve dhe afatet kohore për raportim financiar. Edhe Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës çështjen e auditimit nuk e ka përcaktuar në frymën e kushtetutës së Kosovës.

AP-ja, sipas autoritetit kushtetues e ligjor, ka **qasje të pakufizuar** në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit. Gjatë periudhës raportuese, bashkëpunimi me subjektet e audituara ka qenë korrekt dhe nuk është shënuar ndonjë rast i kufizimit të qasjes për auditorët. Zyrtarëve të autorizuar nga AP-ja u është mundësuar që në çdo kohë të arsyeshme të hyjnë dhe të qëndrojnë në objektet e entiteteve të audituara.

AP-ja e ka autoritetin kushtetues që në mënyrë të pavarur të raportojë në Kuvend gjetjet e çdo viti. Në nëntor të 2021, AP-ja ka prezantuar para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin Vjetor të Auditimit për vitin fiskal 2021. Me këtë rast, AP-ja ka ftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës që të kërkojë rritjen e përgjegjësisë llogaridhënëse nga institucionet e audituara në mënyrë që të ndërmarrin veprime të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve dhe

2 Në bazë të praktikave të mira ndërkombëtare (Deklarata e Limës dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve) për të siguruar pavarësinë e plotë financiare, rekomandohet që buxheti i ISA-ve të trajtohet nga Kuvendi.

3 BQK – Banka Qendrore e Kosovës; AKI – Agjencia Kosovare e Inteligjencës, FKPK – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Ndërmarrja Trepça.

adresimin e mangësive të raportuara. Sikurse edhe gjatë viteve paraprake, ZKA-ja i ka bërë publike të gjitha raportet e auditimit.

2. Qeverisja e brendshme dhe etika

Kjo fushë përfshinë qeverisjen e brendshme dhe etikën, treguesit e të cilave janë, plani strategjik dhe operativ, mjedisi i kontrollit organizativ dhe komunikimi i brendshëm.

2.1. Planifikimi strategjik dhe operativ

ZKA-ja zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në planin strategjik trevjeçar, planin operativ vjetor dhe planin vjetor të auditimit.

Planifikimi Strategjik- Gjatë vitit 2021, ZKA-ja është angazhuar për realizimin e Planit Strategjik 2018-2021, përkatësisht arritjen e qëllimeve strategjike, si: përmbushjen e misionit kushtetues e ligjor, duke kryer auditime relevante në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit; zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale; si dhe zhvillimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira me palët e jashtme.

Sipas vlerësimit të brendshëm të strategjisë 2018-2021, është bërë një progres në përmbushjen e objektivave strategjike të planifikuara si në rrafshin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Prej tre (3) qëllimeve strategjike nga vlerësimet e bëra tregojnë se një (1) është realizuar plotësisht dhe dy (2) pjesërisht, apo shprehur me përqindje 33% me 67% përkatësisht, ndërsa realizimi i objektivave strategjike nga 15 sa ishin planifikuar, 6 janë realizuar (40%), 6 pjesërisht (40%) dhe 3 të pa realizuara (20%).

Duke u nisur nga fakti se plani strategjik 3 vjeçar ka përfunduar, AP ka themeluar një grup punues për hartimin e strategjisë së re tri-vjeçare 2022-2025.

Si bazë për hartimin e strategjisë së re 2022-2025 është marrë edhe vlerësimi i bërë nga ekipi për matjen e performancës së ZKA-së.

Auditorja e Përgjithshme ka vlerësuar se është e rëndësishme që ZKA-ja t'i nënshtrohet vlerësimit të performancës sipas Kornizës së INTOSAI-t për Matjen e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA), dhe, në tetor 2021, ka marrë vendimin për të kryer vetëvlerësimin e performancës së institucionit sipas kësaj kornize.

Procesi i vlerësimit është duke u bërë në mënyrë të pavarur nga ekipi i ZKA-së, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të zyrtarëve të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t.

Qëllimi kryesor i këtij vlerësimi është matja e performancës aktuale të ZKA-së, për të ofruar një pasqyrë të saktë mbi zhvillimin institucional dhe të identifikojë pikat e forta dhe ato të dobëta ku ka nevojë për përmirësim.

Vlerësimi mbulon të gjitha domenet dhe indikatorët sipas KMP-së së ISA-ve, me përjashtim të atyre që nuk janë të aplikueshme për ZKA-në.

Vlerësimi do të nxjerrë në pah progresin, praktikat e mira dhe synimet e ISA-së si dhe dobësitë dhe nevojën për përmirësim. Këto rezultate të vlerësimit do t'i shërbejnë Auditorës së Përgjithshme si udhërrëfyes dhe orientim për planifikimin strategjik për vitet e ardhshme, me qëllim të rritjes së ndikimit të rezultateve të auditimit si dhe zhvillimit të kapaciteteve të ZKA-së.

Plani operativ vjetor – ZKA, edhe në kohë të pandemisë Covid-19 edhe për shkak të kuadrit ligjor ekzistues, i cili obligon Auditorin e Përgjithshëm që të auditojë të gjitha organizatat buxhetore për çdo vit, pavarësisht shkallës së rrezikut dhe rrethanave specifike, ka vazhduar me përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe afateve ligjore në kryerjen e auditimeve.

Me qëllim të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës për shpenzimet publike lidhur me COVID-19, ZKA ka kryer auditime për mënyrën e shpenzimit të fondeve të dedikuara për luftimin e pandemisë.

Plani vjetor i auditimit - Në fillim të sezonit auditues, AP-ja ka miratuar Planin Vjetor të Auditimit 2021/22, i cili përfshinë periudhën 1 shtator 2021 deri më 31 gusht 2022.

ZKA harton për çdo vit planin vjetor të auditimit, i cili përmban informata për objektivat e ZKA-së, llojet e auditimeve, procesin e auditimit, organizimin, buxhetin dhe burimet njerëzore, dhe bashkëpunimin dhe projektet.

Në hartimin e Planit vjetor janë marrë në konsideratë përmbushja e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë, mbulueshmëria sa më e gjerë me auditime të performancës, ku si kriter është vlerësuar rëndësia dhe aktualiteti i çështjeve të caktuara. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh edhe kapacitetet e burimeve njerëzore dhe financiare që ZKA-ja ka pasur në dispozicion. Ky Plan i është dorëzuar për informim KMFP-së në fillim të sezonit auditues.

2.2. Mjedisi i kontrollit organizativ

Në përputhje me kërkesat që burojnë nga ligji, rregulloret dhe SNISA-të, si dhe për të përmbushur pritjet nga ZKA-ja, AP-ja në tetor të vitit 2021 ka miratuar strukturën e re organizative. Struktura e re është në funksion të krijimit të një sistemi të kontrollit të brendshëm që ofron siguri të arsyeshme se operacionet e organizatës menaxhohen në mënyrë efikase dhe efektive, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Kodi i Etikës - ZKA ka Kodin e Etikës i cili është në harmoni me Kodin e Etikës të INTOSAI. Kodi përfshin integritetin, pavarësinë, objektivitetin, kompetencës profesionale, konfidencialitetin, konfliktin e interesit, si dhe zbatohet për të gjithë punonjësit e ZKA-së. Megjithatë, për të ruajtur pavarësinë e institucionit dhe integritetin e auditorëve, AP-ja ka marrë vendim për të rishikuar Kodin i cili së shpejti pritet të aprovohet.

ZKA ka hartuar procedura të shkruara, të cilat ndër tjera kërkojnë që i gjithë personeli dhe palët e autorizuara për të kryer punë për ZKA-në, të pajtohen me kërkesat etike, duke nënshkruar dhe respektuar **Kodin e Etikës** dhe **Deklaratën e pavarësisë profesionale**. Mbi këtë bazë është themeluar edhe Komisioni për çështje etike, i cili përcjell zbatueshmërinë e Kodit të etikës dhe jep konkluzione për çdo rast/ kërkesë nga stafi lidhur me çështjet etike.

Sistemi i kontrollit të brendshëm - Kontrolli i brendshëm për aktivitetet jo audituese kryhet nëpërmjet rregullave dhe procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në ZKA zbatohen: ndarja e detyrave, delegimi, autorizimi, mbikëqyrja dhe auditimi i brendshëm.

ZKA-ja ka hartuar edhe dokumentin për menaxhimin e rreziqeve, i cili zbatohet duke u bazuar në objektivat e vendosura me dokumentet strategjike të ZKA-së dhe kornizën tjetër të aplikueshme për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK). Për më tepër, ZKA-ja ka të dizajnuar një strukturë të mirë të kontrolleve të brendshme. Të gjitha komponentët e kontrolleve operojnë në mënyrë efektive, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve.

Auditimi i brendshëm - ZKA ka një auditor të brendshëm (AB) që përgatit raporte mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm në fusha të ndryshme të organizimit të ZKA-së dhe i raporton drejtpërdrejtë AP-së. Është themeluar edhe Komiteti i Auditimit (KA), i cili kryhen funksionin e tij në përputhje me rregullativën në fuqi.

Gjatë vitit 2021, AB i ka dorëzuar AP-së katër (4) raporte të auditimit, në temat lidhur me: Aktivitetet e prokurimit, Procesi i promovimit dhe transferimit të personelit në ZKA, Menaxhimi i logjistikes dhe Menaxhimi i pasurisë jo financiare në ZKA. Për secilin auditim të kryer, departamentet përkatëse, fushëveprim i këtij auditimi, kanë hartuar planet e veprimit për zbatim të rekomandimeve të auditimit.

KA-ja ka kryer aktivitetet e tij me qëllim të ngritjes së llogaridhënies dhe përmirësimit të qeverisjes në ZKA. Gjatë vitit 2021, janë mbajtur katër takime me qëllim të shqyrtimit të raporteve të AB-së.


2.3. Komunikimi i brendshëm

ZKA-ja ka ndërtuar një komunikim efektiv të brendshëm, duke i dhënë mundësi secilit punonjës të shprehet hapur si në drejtimin vertikal ashtu edhe në atë horizontal për çështjet që lidhen me punën audituese, si dhe për çështje administrative brenda institucionit.

Menaxhmenti i ZKA-së mban takime të rregullta javore, të dokumentuara me procesverbale. Vendimet kryesore dokumentohen dhe i komunikohen stafit. Këto dokumente janë të qasshme për të gjitha nivelet organizative dhe ekziston një mekanizëm për shpërndarjen e informacionit tek stafi.

Ka një rrjet të brendshëm të komunikimit elektronik, përmes së cilit menaxhmenti i ZKA-së i informon rregullisht punonjësit mbi çështjet kryesore të lidhura me organizatën.

Puna audituese dokumentohet dhe raportohet përmes organizimit dhe mirëmbajtjes së folderëve publik dhe SITA-s. Kjo ka rritur transparencën dhe kontrollin e cilësisë së punës sonë.



Kapitulli II

Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit
dhe Raportimi

Kapitulli II

Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi

Kjo fushë ndërlidhet me fushëveprimin/cilësinë e auditimeve, raportimin e rezultateve të auditimeve, adresimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara, si dhe kontrollin e cilësisë.

1. Cilësia e auditimit dhe raportimi

ZKA-ja kryen auditimet në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe praktikave të mira. Po ashtu, për të siguruar cilësinë e auditimeve ka të hartuar doracakët e auditimit financiar me qasje të kombinuar me pajtueshmëri, doracakun për auditime të performancës dhe prokurimit si dhe doracakun për auditime të teknologjisë së informacionit. Për të siguruar se cikli i llogaridhënies lidhur me cilësinë në auditim përmbyllet siç duhet, ka të hartuar edhe udhëzuesin për menaxhimin e cilësisë në auditim. Në bazë të ligjit të ZKA-së, të gjitha raportet e auditimit bëhen publike në web-faqen zyrtare.

Në përputhje me mandatin ligjor dhe fushëveprimin, ZKA kryen këto lloje të auditimeve:

- Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë të organizatave buxhetore (bazuar në sistemin e parasë së gatshme) dhe të ndërmarrjeve publike (bazuar në sistemin aktual); dhe
- Auditime të performancës, përfshirë auditimet e teknologjisë së informacionit.

Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë - përfshinë auditimin e PFV-ve të institucionit me qëllim të vlerësimit nëse raportet janë të besueshme dhe pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë; vlerësimin nëse menaxhmenti iu ka përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm.

Objektivat e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë përkufizohen si siguri e arsyeshme, e cila i ofrohet shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, nëse pasqyrat financiare të audituara janë në tërë kuptimin material të vërteta dhe të drejta (apo

të paraqitura drejtë) dhe nëse transaksionet e raportuara në ato pasqyra janë kryer në pajtueshmëri me autoritetet⁴.

Sipas SNISA-ve të përditësuara, auditimet e rregullsisë së PVF-ve janë auditime financiare dhe auditime të pajtueshmërisë (qasje e kombinuar), prandaj në vazhdim po japim përkufizimet për objektivat e llojeve të auditimeve.

- Objektivi i **auditimit financiar** të pasqyrave financiare është të rrisë nivelin e besimit tek përdoruesit e pasqyrave financiare. Kjo arrihet përmes dhënies së opinionit nga ana e auditorit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën raportuese në fuqi; si dhe të ofrojë siguri të arsyeshme se informacioni financiar në raportin vjetor financiar është i vërtetë, i drejtë dhe konsistent me Kornizën për raportim financiar dhe Kornizën rregullative.
- Objektivi i **auditimit të pajtueshmërisë** është që të informojë përdoruesit nëse entitetet publike të audituara respektojnë vendimet e Kuvendit, ligjet, aktet legjislativë, politikat, kodet, praktikat e mira, si dhe të ofrojë siguri se proceset raportuese të kontabilitetit/financiare dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me autoritetet.

Qëllimi gjithëpërfshirës i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë është të rritet niveli i besueshmërisë së përdoruesve të synuar të Pasqyrave Financiare dhe përdorimi i fondeve publike në pajtueshmëri me autoritetet.

Auditimet financiare dhe pajtueshmërisë kryhen çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti vjetor i auditimit (RVA) për Raportin financiar vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

Auditimet e performancës - paraqesin një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit (minimizimi i kostove të burimeve), efikasitetit (përfitimimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe efektivitetit (përmbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara). Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA-ja ndjek një rëndësi nga tri qasjet: qasjen

⁴ "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë përputhshmëri me aktet apo rezolutat e legjislativës apo instrumente tjera statutore, direktiva dhe udhëzues të nxjerra nga organet e sektorit publik me kompetenca të përcaktuara me statut, të cilave pritet t'i përmbahet entiteti i audituar. Thënë ndryshe, është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

e orientuar në rezultate, qasjen e orientuar në problem dhe qasjen e orientuar në sistem, ose një kombinim të të tri qasjeve.

Auditimet e teknologjisë së informacionit (TI)- pasqyrojnë vlerësimin dhe rishikimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrollet e ndërlidhura me to, për të përfituar siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së.

Në terma të përgjithshëm, auditimet e TI-së shtrihen në auditimet financiare, në auditimet e pajtueshmërisë, në auditimet e performancës, por mund të realizohen edhe si auditime të veçanta.

2. Auditimet e realizuara dhe të planifikuara

Gjatë vitit 2021, ZKA-ja ka kryer dhe publikuar 131 raporte auditimi, si në vijim:

116 Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)

- Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2020,
- 90 raporte për organizatat buxhetore,
- 12 raporte të auditimit për Ndërmarrjet Publike, dhe
- 13 raporte të auditimit të projekteve (financuara nga donatorët).

13 raporte të auditimit të performancës,

- 13 raporte të auditimit të performancës (për fusha të ndryshme si: shëndetësia, investimet publike dhe infrastrukturë, prokurimi publik, mjedisi dhe teknologjia e informacionit).

2 raporte të pajtueshmërisë. Këto auditime janë kryer në periudhën shtator-nëntor të vitit 2021.

Në kuadër të auditimeve të performancës dhe pajtueshmërisë janë përfshirë edhe katër auditime të kryera me kërkesë të Kuvendit të Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

Në Planin Vjetor për sezonin e auditimit **2021/22**, ZKA-ja planifikon të kryejë dhe të publikojë 134 auditime, si në vijim:

117 Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)

- Auditimin e Raportit Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2021,
- 90 organizata buxhetore (52 institucione të nivelit qendror dhe 38 të nivelit lokal)⁵
- 12 Ndërmarrje Publike, dhe
- 14 auditime të projekteve (financuara nga donatorët).

15 Auditime të performancës

- 11 auditime të performancës (për fusha të ndryshme si: Arsimi, Zhvillimi ekonomik dhe mjedisi, Trepça, Transmetuesi publik-RTK, Prokurimi publik),
- 4 auditime të pa përfunduar nga viti i kaluar (për fusha të ndryshme).

2 auditime të pajtueshmërisë

Auditimet me kërkesë nga Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë kanë qenë pjesë e planit të auditimit për sezonin auditues 2021/22, mirëpo të njëjtat janë kryer në tremujorin e fundit të vitit 2021. Në portofolin e auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë kemi një zvogëlim të ministrive për arsye të ristrukturimit të Qeverisë dhe një rritje të auditimit të projekteve të financuara nga donatorët e jashtëm.

Vlen të theksohet që ZKA-ja, në vitin 2021, ka filluar me auditimin e informatave të klasifikuara me ligjin Nr.03/L-178 për klasifikim të informacionit dhe verifikimin e sigurisë. Kemi filluar me auditimin e informatave të klasifikuara me nivel të "KUFIZUAR" dhe në të ardhmen pritet që auditimet të shtrihen në nivele më të larta të sigurisë.

5 ZKA-ja ka angazhuar një kompani private të auditimit, e cila do të përkrahë procesin auditimit të 19 Institucioneve të Pavarura dhe gjashtë komunave. Megjithatë, sigurimi i cilësisë së raporteve dhe dhënia e opinionit të auditimit do të bëhet nga AP-ja.

Tabela 1. tregon numrin e përgjithshëm të auditimeve dhe llojet e auditimeve të paraqitura me një bazë krahasuese për tre (3) sezone/vitet e fundit të auditimit. Të dhënat e raporteve të përfunduara dhe të auditimeve në proces janë paraqitur në **Shtojcën 1** të këtij raporti.

Tabela 1. Numri dhe llojet e auditimeve në tri vitet e fundit.

Llojet e auditimeve	Sezoni i auditimit /plani vjetor		
	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Auditime të rregullsisë	117	116	119
Buxheti i Kosovës	1	1	1
Institucionet Qendrore	52	52	57
Komunat	38	38	38
Ndërmarrjet Publike	12	12	14
Projekte	14	13	9
Auditimet e Performancës	15	8	8
Performancë dhe Prokurim	8	5	8
Teknologji Informative	3	3	0
Auditime të pa përfunduara nga viti paraprak.	4		
Auditime të Pajtueshmërisë	2	0	0
Gjithsej	134	124	127

Duke krahasuar vitin 2019 me 2021, paraqitur në tabelën 1 dhe grafikun 1, kemi një rritje të numrit të auditimeve nga 127 në 134 sosh, apo 7 auditime më shumë.

Rritja për këtë sezon auditues 2021/22 vërehet tek auditimet e rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) së 14 projekteve të financuara nga donatorët. Prej të cilave, 12 projekte të financuara nga Banka Botërore dhe dy të financuara nga Agjencia Suedeze për Zhvillim (SIDA).

Në këtë sezon auditues si risi janë planifikuar të kryhen dy auditime të pajtueshmërisë, si dhe të përfundohen 4 auditime të performancës të planifikuar në vitin paraprak.


Për dallim nga sezoni i kaluar, numri i auditimeve të performancës është rritur, duke përfshirë tema nga fusha të rëndësishme, si: arsimit, ekonomia, mjedisi, transmetuesi publik, investimet publike (prokurimi publik), dhe teknologjia e informacionit.

Përveç fushave që ZKA mbulon thuaja se çdo vit me auditimet e performancës, këtë vit ka shtrirë fushëveprimin më shumë në ndërmarrje publike, si dhe në transmetuesin publik. Menaxhmenti i ZKA-së ka vendosur të kryejë auditimin për transmetuesin publik të Kosovës (RTK- duke i përfshirë lloje të auditimit, financiar dhe performancë), si dhe KEK, Trepçë dhe KOSST-in.

Po ashtu, kemi filluar edhe me auditime të veçanta të pajtueshmërisë, për të vlerësuar pajtueshmërinë e aktiviteteve, programeve, pagesave me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Në këtë sezonë audituese, janë përfshirë edhe tema me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe MD-së.

Grafiku 1. Numri dhe llojet e auditimeve në tri vitet e fundit.



Në grafikun 1 në raport me vitet paraprake kemi një rritje të numrit të auditimeve për 7- sosh më shumë.

3. Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve të auditimit (financiar dhe të pajtueshmërisë)

Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Pasqyrat Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës të vitit 2020 është dorëzuar në Kuvendin e Kosovës brenda afatit ligjor në gusht të viti 2021. Auditori i Përgjithshëm ka prezantuar RVA-në në seancë plenare.

Çështjet kryesore të RVA-së - auditimet kanë nxjerr në pah disa mangësi dhe dobësi në shumicën e organizatave buxhetore, të cilat kanë rezultuar në menaxhim të dobët të fondeve buxhetore si dhe mos arritjen e vlerës për para. Si konkluzion kryesor i raportit nënvizohet nevoja për një vëmendje më të shtuar të drejtuesve të lartë dhe mbajtësve të buxhetit për forcimin e masave dhe përmirësimin e proceseve në fushat si në vijim:

- cilësinë e raportimit,
- planifikimin dhe realizimin e buxhetit,
- kontrollet e vlefshmërisë së dhënave në SIMFK,
- keq klasifikimet e shpenzimeve,
- mos efikasitetin në shpenzimin e fondeve nga borxhet publike,
- menaxhimin e llogarive të arkëtueshme,
- detyrimet e papaguara dhe detyrimet kontingjente,
- regjistrimin, prezantimin dhe trajtimin jo adekuat të pasurive, si dhe
- zbatimin e rekomandimeve.

Për çështjet e prezantuara në RVA janë dhënë rekomandime përkatëse.


Edhe pse nuk janë bërë vlerësime individuale për të kuptuar më saktë ndikimin e rekomandimeve të auditimit për subjektet e audituara, konkluzioni i përgjithshëm është se ndikimi i punës së ZKA-së mund të vërehet në fushat si në vijim: zvogëlimi i transaksioneve financiare të parregullta; përmirësimi i gabimeve si rezultat i auditimit; dhe rritja e transparencës për shpenzimin e parasë publike (të gjitha raportet e auditimit janë publikuar dhe raportet e performancës janë prezantuar para publikut dhe palëve të interesit).

Tabela 2. Progresi i zbatimit të rekomandimeve në vitin 2020 për vitit 2019 nga OB

Auditimet sipas fushave	Nr.	Të zbatuara		Të adresuara pjesërisht apo në proces %		Të pa zbatuara		Të mbyllura të pa zbatuara %	
			%		%		%		%
Institucionet e nivelit qendror	226	138	52%	10	4%	71	27%	47	18%
Institucionet e pavarura	54	30	56%	0	0%	16	30%	8	13%
Institucionet e nivelit lokal	483	197	41%	43	9%	183	38%	60	12%
Gjithsej	803	365	45%	53	7%	271	34%	114	14%

Në raportet individuale të auditimit të organizatave buxhetore dhe NP-ve, të realizuara gjatë vitit 2021, të cilat kishin në fokus pasqyrat financiare të vitit 2020, është raportuar edhe progresi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna një vit më parë. Ky progres është paraqitur në tabelën (2 dhe grafikun 2).

Grafiku 2. Progresi i zbatimit të rekomandimeve në vitin 2020 për vitit 2019 nga OB



Në tabelë vërehet se ZKA në raportet e auditimit të vitit 2019 kishte dhënë 803 rekomandime dhe gjatë auditimit në vitin 2020 kishte vlerësuar zbatimin e rekomandimeve. Sipas këtij vlerësimi, 45% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 7% ishin zbatuar pjesërisht, 34% nuk janë zbatuar fare, ndërsa 14% janë mbyllur si të pa zbatuara.


ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

Sa i përket Ndërmarrjeve Publike, ZKA-ja ka audituar (14) sosh për vitin fiskal 2020. Rezultatet nga përcjellja dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve për këto NP janë paraqitur më poshtë.

Tabela 3. Progresi i zbatimit të rekomandimeve nga Ndërmarrjet Publike të audituara në vitin 2020 për vitin 2019.

Nr.	Ndërmarrjet Publike të audituara	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara		Të adresuara pjesërisht apo në proces		Të mbyllura		Të pa zbatuara	
		Nr.	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
1	Hekurudhat e Kosovës - Trainkos	10	5	50%					5	50%
2	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK)	9	9	100%						
3	KRU Prishtina	36	9	25%	3	8%	2		22	61%
4	KRU Hidroregjioni Jugor	11	6	55%	4	36%			1	9%
5	KRU Drini Bardhe	20	13	65%	1	5%			6	30%
6	KRM Uniteti									
7	KRM Pastrimi	44	24	55%					20	45%
8	Stacioni i Autobusëve									
9	Hortikultura	6	4	67%	2	33%				
10	Posta e Kosovës	25	18	72%	2	8%			5	20%
11	Telekomi i Kosovës	36	16	44%	4	11%			16	44%
12	Bifurkacioni	34	22	65%	4	12%			8	24%
13	Hidromorava	11	6	55%	1	9%			4	36%
14	Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës	2	1						1	50%
	Gjithsej	244	133	55%	21		2		88	

Grafiku 3. Progresi i zbatimit të rekomandimeve nga Ndërmarrjet Publike të audituara në vitin 2020 për vitin 2019.



Nga tabela dhe grafiku më lartë vërehet se ZKA, në raportet e auditimit të vitit 2019, kishte dhënë 244 rekomandime dhe gjatë auditimit në vitin 2020 kishte vlerësuar zbatimin e rekomandimeve. Sipas këtij vlerësimi, 54% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 9% janë në proces të zbatimit, 1% ishin mbyllur të pazbatuara dhe 36% edhe me tutje nuk janë zbatuar.

4. Auditimet e performancës

Raportet e auditimit të performancës të publikuara gjatë vitit 2021 kanë mbuluar fusha me interes për qytetarët, Kuvendin e Kosovës dhe palët e tjera të interesit. Fokus i auditimeve për vitin 2021 ishin: zhvillimi ekonomik, mirëqenia sociale, shëndetësi, mjedisi dhe siguria, teknologjia e informacionit si dhe fusha e prokurimit publik.

Përmes këtyre auditimeve, ZKA ka synuar të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin, vlerën për para dhe transparencën e administratës publike. Gjatë vitit 2021, rëndësi e veçantë i është dhënë kryerjes së auditimeve të performancës për pandeminë COVID 19, më qëllim që t'i ofrojë Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës një informacion lidhur me menaxhimin e pandemisë në Republikën e Kosovës.

Tabela 4. Temat e auditimeve të performancës, prokurimit dhe TI-së sipas fushave

Numri i auditimeve	Fusha	Tema
3	Zhvillimi ekonomik, Infrastruktura, mirëqenie sociale	Vlera për para në ndërtimin e rrugëve rajonale dhe lokale
		Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare
		Vendimmarrjet lidhur me strukturën organizative dhe Alpex dega në Kosovë – Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut –KOSTT
2	Shëndetësi	Furnizimi me barëra dhe materiale shëndetësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19
		Optimizimi i resurseve njerëzore dhe pajisjeve teknike mjekësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19
2	Mjedisi dhe siguria	Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet
		Mbledhja, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave komerciale
4	Prokurimit publik dhe projekte	Kontratat e centralizuara - Shërbimet e transportit ajror
		Vlera për para në prokurimet e centralizuara, pjesa e dytë
		Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale, për vitin 2019
		Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale SDC/DEMOS për vitin fiskal 2020
2	Teknologji e informacionit	Sistemi për menaxhimin informativ të lëndëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës
		Sistemet elektronike për menaxhimin e garantëve dhe subvencioneve në AZhB-MBPZHR

Përveç këtyre auditimeve, gjatë vitit 2021 janë kryer edhe tri (3) auditime me kërkesë nga Kuvendi i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë. Tabela 6. tregon numrin e përgjithshëm të auditimeve, përfshirë llojet e auditimeve të paraqitura me një bazë krahasuese për tri (3) vitet e fundit të auditimit.

Tabela 5. Numri i përgjithshëm i auditimeve gjatë tri viteve të fundit

Auditime të performancës	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019
Performancë dhe prokurim	11	5	13
Teknologji të Informacionit	2	3	-
Gjithsej	13	8	13

Gjatë vitit 2021 janë publikuar (11) njëmbëdhjetë raporte të auditimit të performancës, prokurimit dhe projekteve, si dhe dy auditime të teknologjisë së informacionit. Trendi i auditimeve të performancës përkundër situatës me pandeminë Covid'19 ka shënuar rritje.

Mesazhet kryesore për auditimet e performancës janë në vijim.

- **Furnizimi me barëra dhe materiale shëndetësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19**

Fokusi - i auditimit ishte vlerësimi nëse institucionet përgjegjëse shëndetësore kanë arritur të kryejnë furnizimet e duhura të barërave dhe materialeve tjera shëndetësore me kohë për të siguruar se i përgjigjen nevojave të pacientëve me COVID-19. Është vlerësuar nëse është bërë analiza e nevojave, procesi i furnizimit dhe nëse vendimet për furnizime/blerje janë bërë me kohë dhe në mënyrën e duhur. Auditimi ka përfshirë: Ministrinë e Shëndetësisë dhe Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës si institucionet kryesore për furnizim me barna dhe materiale shëndetësore.

Rezultatet e auditimit - tregojnë që institucionet publike shëndetësore, përkundër sfidave, kanë arritur të riorganizojnë dhe të vendosin disa procese të duhura, të cilat kanë ndihmuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për pacientët me COVID-19 bazuar në mundësitë dhe kapacitetet teknike dhe resurset njerëzore në dispozicion për trajtimin e pacientëve.

Megjithatë, institucionet shëndetësore nuk kanë arritur të sigurojnë me kohë të gjitha barërat dhe materialet e nevojshme shëndetësore për trajtimin e pacientëve me COVID-19. Prandaj, në shumë raste pacientët janë detyruar që vetë t'i blejnë disa nga barërat për trajtim mjekësor. Institucionet shëndetësore, dhe në veçanti Ministria e Shëndetësisë, nuk kanë arritur ti sigurojnë barërat e nevojshme për trajtimin e pacientëve me COVID -19 edhe pse ka qenë obligim institucional mbulimi i shpenzimeve për trajtimin e tyre deri në shërimin e plotë. Blerja e barërave nga pacientët me COVID-19, si atyre të hospitalizuar ashtu edhe atyre me 'simptoma

të buta' që janë trajtuar në shtëpi, tregon faktin që institucionet publike nuk kanë arritur t'iu ofrojnë medikamentet dhe bazën materiale të nevojshme.

Përkundër përpjekjeve që t'i përgjigjen si duhet dhe me kohë nevojave për trajtimin e pacientëve me COVID 19, auditimi ka identifikuar disa mangësi, të cilat kanë ndikuar që furnizimi me barëra dhe materiale shëndetësore i institucioneve shëndetësore gjatë pandemisë të mos arrij nivelin e duhur. Këto mangësi janë ndikuar në masë të madhe nga mos funksionalizimi i plotë i Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh).

Për këtë auditim janë dhënë dy rekomandime për Qeverinë dhe 12 rekomandime për institucionet shëndetësore.

• **Optimizimi i burimeve njerëzore dhe pajisjeve teknike mjekësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19**

Fokusi - i këtij auditimi ishte vlerësimi nëse institucionet përgjegjëse shëndetësore kanë arritur të menaxhojnë siç duhet me burimet njerëzore dhe teknike mjekësore për të siguruar se i përgjigjen nevojave të pacientëve me COVID-19. Auditimi ka përfshirë; Ministrinë e Shëndetësisë, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, spitali rajonal i Prizrenit dhe spitali rajonal i Pejës.

Institucionet publike shëndetësore, përkundër sfidave, kanë arritur të riorganizojnë dhe të vendosin disa procese të duhura të cilat kanë ndihmuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për pacientët me COVID-19.

Optimizimi i burimeve njerëzore dhe pajisjeve teknike mjekësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19 është realizuar nga institucionet e shëndetit publik duke iu përgjigjur pjesërisht nevojave krahas numrit të pacientëve të infektuar dhe duke u përditësuar në vazhdimësi me udhëzimet e institucioneve ndërkombëtare shëndetësore.

Megjithatë, auditimi ka identifikuar disa mangësi, të cilat kanë ndikuar që ofrimi i shërbimeve për trajtimin e pacientëve gjatë pandemisë të mos arrijë nivelin e duhur. Këto mangësi janë shkaktuar në masë të madhe nga mos funksionalizimi i plotë i Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh).

Institucionet shëndetësore nuk kanë siguruar personel të mjaftueshëm shëndetësor për t'u përballur me pandeminë COVID-19. Edhe pse institucionet shëndetësore kanë themeluar komisione të veçanta për menaxhimin e personelit shëndetësor gjatë pandemisë COVID-19, të njëjtat nuk kanë arritur të zhvillojnë analiza me kohë lidhur me nevojat për personel.

Institucionet shëndetësore nuk janë koordinuar dhe nuk kanë komunikuar në mënyrë sistematike gjatë pandemisë. Këto institucione nuk kanë hartuar plane të veprimit për menaxhimin e hapësirave spitalore për trajtimin e pacientëve me COVID-19 me përjashtim të spitalit të Prizrenit, ndërsa SHSKUK-ja kishte hartuar një plan të veprimit në janar të vitit 2021. SHSKUK-ja nuk ka pasur një plan veprimi

për menaxhimin e pajisjeve mjekësore të nevojshme për trajtimin e pacientëve me COVID-19.

Për këtë auditim janë dhënë një rekomandim me prioritet për Qeverinë dhe 15 rekomandime për institucionet shëndetësore.

• **Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet**

Fokusi - i auditimi ishte të vlerësohej nëse Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave dhe institucionet tjera relevante kanë arritur të krijojnë një sistem të përshtatshëm i cili siguron në mënyrë efektive parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente me fokus tek vërshimet/përmbytjet në Republikën e Kosovës. Subjekt i auditimit ishin: Agjencia për Menaxhim Emergjent në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qendra e Situatave në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës si dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Përderisa në nivel lokal, komunat Gjakovë dhe Vushtrri.

Rezultatet e auditimit - kanë konstatuar se institucionet përgjegjëse në nivelin qendror dhe atë lokal, nuk kanë arritur të krijojnë një sistem të përshtatshëm i cili siguron në mënyrë efektive parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente të vërshimeve/përmbytjeve në Republikën e Kosovës.

Dokumentet strategjike nuk janë përditësuar duke mos i marrë parasysh ndryshimet dhe nevojat e palëve të përfshira në menaxhimin e situatave emergjente. Gjithashtu, dokumenti i vlerësimit të rrezikut në nivel vendi nuk është përditësuar që nga viti 2016 dhe të dhënat historike mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera nuk janë të plota. Mungon monitorimi i aktiviteteve të parandalimit dhe matjes së performancës të Njësive Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim. Niveli qendror dhe lokal nuk kanë arritur të sigurojnë burimet njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente/vërshimet.

Me qëllim të rregullimit të mënyrës së menaxhimit të emergjencave, janë dhënë 11 rekomandime për institucionet përgjegjëse.

• **Mbledhja, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave komerciale**

Fokusi - i auditimi ishte të vlerësojmë nëse institucionet përgjegjëse janë duke bërë mbledhjen, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave komerciale në mënyrë efektive, me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve që ndikojnë në mjedisin dhe shëndetin e qytetarëve. Subjekte të këtij auditimi ishin; Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Kompanitë Regjionale të Mbeturinave “Pastrimi” dhe “Pastërtia”; Komuna e Ferizajt dhe e Fushë Kosovës; Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë, si dhe Agjencia për Ushqim dhe Veterinari.

Rezultatet e auditimit - tregojnë se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Komuna e Ferizajt, dhe Komuna e Fushë Kosovës nuk kanë arritur të krijojnë kushte për ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave dhe për pasojë rrezikohet mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit të njeriut. Po ashtu ndarja e mbeturinave

komerciale gjatë procesit të grumbullimit dhe deponimit nuk bëhet në burim. Për më tepër edhe monitorimi dhe inspektimi nga këto institucione është i kufizuar.

Pavarësisht ndërtimit të dy impianteve në vlerë mbi 11 milionë euro, njëra për ndarje të përgjithshme të mbeturinave dhe tjetra për mbetje shtazore, ato nuk janë funksionalizuar. Kjo ka pamundësuar trajtimin e mbeturinave sipas kategorizimit të duhur, përderisa makineritë vazhdojnë të amortizohen pa u përdorur fare. Kompanitë Regjionale të Mbeturinave gjatë grumbullimit nuk i ndajnë mbeturinat sipas katalogut shtetëror për mbeturina dhe një gjë e tillë nuk bëhet as nga Kompania për enaxhimin e Deponive në Kosovë. Kategorizimi i mbeturinave për biznese kundrejt atyre të amvisërive bëhet vetëm për çështje të tarifës.

Ky auditim ka vë në pah se mbrojtja e mjedisit është e rrezikuar pasi që deponitë sanitare dhe stacionet e transferit vazhdojnë të mos kenë leje të integruara duke rrezikuar ujin, ajrin dhe tokën.

Më qëllim të përmirësimit të gjendjes aktuale në menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit janë dhënë 10 rekomandime për institucionet përgjegjëse.

• **Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare**

Fokusi- i auditimi ishte të vlerësojmë nëse institucioneve publike kanë arritur të menaxhojnë procesin e financimit të OJQ-ve në mënyrën e duhur, me transparencë të plotë si dhe nëse kanë siguruar që financimi i OJQ-ve/zbatimi i projekteve dhe programeve të OJQ-ve i përgjigjet prioriteteve dhe nuk devijon nga qëllimi i synuar. Fushëveprimi i auditimi ishin Zyra e Kryeministrit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komuna e Prishtinës.

Rezultatet e auditimit - kanë identifikuar mangësi në procesin e financimit të organizatave joqeveritare nga institucionet publike të audituara, të cilat rrezikojnë llogaridhënien, transparencën, konkurrencën dhe arritjen e qëllimeve të synuara. Rezultatet e auditimit tregojnë se institucionet publike kanë financuar drejtpërdrejt projekte të ndryshme pa thirrje publike, pa plotësimin e kriterëve dhe vetëm me vendime të udhëheqësve, krerëve të drejtorive dhe departamenteve përkatëse. Në rastet kur kishte thirrje publike, ato nuk ishin në harmoni me kriteret e përcaktuara dhe si të tilla nuk ishin të qarta. Për më tepër, organizatat joqeveritare janë përkrahur nga më shumë se një burim i financimit publik për projektin e njëjtë nga institucionet publike, ishin financuar operatorë ekonomik të cilët nuk ishin organizata joqeveritare, si dhe ishin identifikuar raste të konfliktit të interesit.

Çështje tjetër me rëndësi është mos vlerësimi i rezultateve për projektet e financuara, si pasojë e mungesës së monitorimit të projekteve. Institucionet publike nuk kanë arritur të monitorojnë ecurinë e projekteve dhe organizatat joqeveritare nuk janë mbajtur përgjegjës për zbatimin e projekteve. Si rezultat, nuk ka një vlerësim nëse janë arritur qëllimet e synuara dhe nëse fushat e caktuara janë përmirësuar nga financimet e dhëna për organizatat joqeveritare.

Me qëllim të adresimit të çështjeve rreth menaxhimit të procesit të financimit të organizatave jo-qeveritare si dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, ishin dhënë nëntë (9) rekomandime për institucionet përgjegjëse.

- **Vlera për para në ndërtimin e rrugëve rajonale dhe lokale**

Fokusi i auditimi ishte të vlerësohet nëse është arritur vlera për para në ndërtimin e rrugëve rajonale dhe lokale dhe nëse rrugët e ndërtuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe komunat Prishtinë, Prizren, Ferizaj dhe Malishevë përfundohen me kohë dhe me cilësinë e pranuar me standarde.

Rezultatet e auditimit janë se ndërtimi rrugëve lokale dhe rajonale përcillet me mangësi të shumta duke filluar nga mungesa e analizës kosto-përfitime, planifikimi jo adekuat i aktiviteteve, buxhetimi i pamjaftueshëm, problemet me shpronësime, problemet me hartimin e projekteve kryesore dhe paqartësi sa i përket referimit në standarde të ndërtimit të rrugëve. Për pasojë, ndërtimi i rrugëve ishte përcjellë me vonesa deri në tri vite e disa kishin mbetur pa përfunduar edhe pesë vite pas fillimit të tyre. Prandaj në shumicën e projekteve të audituara nuk është siguruar vlera më e mirë për para.

Ministria e Infrastrukturës dhe komunat e audituara kishin shpallur tenderë pa u siguruar se janë plotësuar parakushtet për fillimin e tyre (shpronësimet etj.). Inicimin e aktivitetit të prokurimit dhe lidhjen e kontratave e kishin bërë në kohë të papërshtatshme gjë që kishte pamundësuar zbatimin e pandërprerë të kontratave. Këto entitete nuk kishin buxhetuar fonde të mjaftueshme për të siguruar zbatimin pa ndërprerje të kontratave. Fondet ishin buxhetuar vetëm pas dy apo tri vitesh gjë që gjithashtu kishte shkaktuar vonesa në zbatimin e kontratave.

Nuk është bërë analiza për kosto-përfitime të projekteve për ndërtimin dhe dizajnin e rrugëve, përfshirë standardet e aplikueshme për ndërtimin e tyre në aspektin teknik/ndërtimor. Për pasojë, dizajni i rrugëve ishte i ndryshëm (gjerësia e rrugës në veçanti dallonte nga komuna në komunë) dhe nuk kishte dizajn uniform bazuar në një standard unik.

Me qëllim të adresimit të këtyre çështjeve që ndërlidhen me ndërtimin e rrugëve, ishin dhënë nëntë (9) rekomandime për institucionet përgjegjëse.

- **Kontratat e centralizuara - Shërbimet e transportit ajror**

Fokusi i auditimi ishte të vlerësohet se si Agjencia Qendrore e Prokurimit (tutje AQP), në koordinim me organizatat buxhetore të përfshira në kontratën e centralizuar të shërbimeve të transportit ajror, kishte vlerësuar nevojat për furnizim me bileta dhe se si organizatat buxhetore i kanë menaxhuar kontratat për shërbime të transportit ajror dhe nëse janë furnizuar në përputhje me kontratat.

Rezultatet e auditimit kanë konstatuar se disa organizata buxhetore kishin bërë më shumë shpenzime se sa që kishin parashikuar fillimisht, kryesisht për shkak se çmimi mesatar i biletës së blerë ishte më i lartë se çmimi mesatar i biletës së

parashikuar në proces të prokurimit nga AQP. Kjo për shkak të numrit të madh të biletave të klasave më të larta se klasa ekonomike e udhëtimit.

Organizatave buxhetore kishin anuluar numër të konsiderueshëm të biletave, ndërsa kishin arritur të rimbursojnë prej 5% deri në 97% të çmimit blerës të biletës. Gjithsej vlera që nuk kishin mundur ta rimbursojnë ishte rreth 16,000€. Për shtyrje të datës së udhëtimit ishin paguar mbi 2,700€.

Çështjet e identifikuar gjatë auditimit tregojnë se ekziston nevoja për përmirësime në procesin e furnizimit me shërbime të transportit ajror. Për këtë qëllim ishin dhënë shtatë (7) rekomandime për institucionet përgjegjëse.

• **Vlera për para në prokurimet e centralizuara- pjesa e dytë**

Fokusi i auditimit ishte vlerësimi nëse është arritur vlera për para në aktivitetet e centralizuara të prokurimit, gjegjësisht a janë arritur kursime buxhetore, si dhe a ka nxjerrë mësim Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) nga përvoja në prokurimet e para të centralizuara.

Rezultatet e auditimit janë se AQP, përmes aktiviteteve të centralizuara të prokurimit, i kishte kursyer organizatave buxhetore 2.5% të mjeteve të dedikuara për prokurimin e mallrave të caktuara. Në përgjithësi, çmimet e artikujve të prokuruar përmes kontratave të centralizuara ishin më të ulëta se sa çmimet e artikujve përkatës në kontrata individuale. Shuma totale e kursyer vetëm në tri kontrata të centralizuara, me vlerë të përgjithshme prej 19 milion euro, ishte mbi 477 mijë €.

Mirëpo, jo të gjithë artikujt në këto kontrata kishin çmime më të ulëta krahasuar me kontratat individuale. AQP nuk iu kishte siguruar kursime disa organizatave buxhetore, përkundrazi iu kishte shkaktuar shpenzime shtesë, afërsisht 105 mijë €.

Përveç kursimit prej 477 mijë eurove, AQP do të mund të kursente edhe afër 514 mijë euro sikur gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të kontratës t'iu kishte referuar çmimeve më të ulëta të kontratave individuale. Kursimi total që do të arrinte mbi një milion €, ose mbi 5% të buxhetit të shpenzuar në vetëm tri kontrata të centralizuara.

AQP kishte mangësi në komunikim me shfrytëzuesit e kontratave të centralizuara. Për pasojë kishte mbivlerësim ose nënvlerësim të nevojave, shkak për realizimin e ulët ose të tepërt kontratave. Mungesa e monitorimit efektiv kishte bërë që AQP të mos ndërmarr veprime korigjuese kur kontratat nuk ishin duke u zbatuar siç ishin paraparë. Veprimet korigjuese ishin të vonuara pa asnjë efekt.

AQP nuk kishte bërë analizë të efekteve të prokurimit të centralizuar, për të konstatuar se a po rezultojnë me kursime apo me shpenzime shtesë dhe për të marrë vendim se a duhet të vazhdohet me prokurim të centralizuar apo jo.

Bazuar në çështjet e identifikuar rezulton se ka nevojë për përmirësime në procesin e prokurimit të centralizuar. Për këtë auditim ishin dhënë gjashtë (6) rekomandime për Agjencinë Qendrore të Prokurimit si përgjegjëse për zhvillimin e prokurimeve të centralizuara.

• Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale për vitin 2019

Auditimi është realizuar në bazë të marrëveshjes në mes të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim përmes Projektit për Decentralizim dhe Përkrahje Komunale.

Fokusi i auditimi ishte vlerësimi nëse shpenzimet dhe menaxhimi i projekteve kapitale të Grantit të Performancës Komunale (tutje GPK) janë në harmoni me kërkesat e marrëveshjes dhe nëse këto projekte kanë arritur rezultatet e synuara. GPK është bashkë financiar nga Fondi Zviceran në Kosovë/Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave dhe Ministria e Pushtetit Lokal. Subjekt i auditimit ishin projektet në komunat Prizren, Glllogoc, Vushtrri, Viti, Shtërpçë dhe Obiliq. Për vitin 2019 nga ky Grant kanë përfituar 19 komuna në vlerë rreth 2,7 milion €. Ne kemi audituara projektet në këto gjashtë komuna në vlerë 912,441€ apo rreth 33% të shumës së Grantit.

Komunat e audituara kishin aplikuar procedurat e prokurimit publik në fuqi ashtu siç parashihen me kërkesat e Grantit, duke filluar nga përfshirja e projekteve në planin e prokurimit publik, zhvillimi i procedurave adekuate/të hapura të prokurimit dhe emërimin e menaxherëve të kontratave sipas kërkesave në fuqi.

Rezultatet e auditimit kanë nxjerr në pah se komunat e audituara ende nuk kishin procese standarde të pranimit të kërkesave nga qytetarët, shqyrtimin e tyre dhe prioritizimin e nevojave për investim. Më shumë se gjysma e projekteve nuk ishin përfunduar me kohë për arsye si: inicimi me vonesë i procedurave të prokurimit, nënshkrimi i kontratave në fund të vitit, mos ofrimi i kushteve të përshtatshme të punës për Operatorët Ekonomik dhe mos përgjegjshmëria e Operatorëve Ekonomik ndaj kontratës.

Çështjet e identifikuara gjatë auditimit tregojnë se ekziston nevoja për përmirësime në procesin e menaxhimit të këtyre projekteve. Për këtë qëllim ishin dhënë katër (4) rekomandime për institucionet përgjegjëse.

• Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale SDC/DEMOS për vitin fiskal 2020

Auditimi është realizuar në bazë të marrëveshjes në mes të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim përmes Projektit për Decentralizim dhe Përkrahje Komunale.

Fokusi i auditimi ishte të vlerësojë nëse shpenzimet dhe menaxhimi i projekteve kapitale të Grantit të Performancës Komunale janë në harmoni me kërkesat e marrëveshjes dhe nëse këto projekte kanë arritur rezultatet e synuara. GPK është bashkë financiar nga Fondi Zviceran në Kosovë/Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave dhe Ministria e Pushtetit Lokal. Subjekt i auditimit ishin komunat Pejë, Mitrovicë e Jugut, Klllokot dhe Gjakovë. Për vitin 2020 nga ky Grant

kanë përfituar 23 komuna në vlerë 2,4 milion €. Ne kemi audituara projektet në këto katër komuna në vlerë 996,272€ apo 42% të shumës së Grantit.

Rezultatet e auditimit tregojnë se Granti i Performancës Komunale në përgjithësi i ka ndihmuar komunat në arritjen e objektivave strategjike dhe është arritur qëllimi për të ofruar shërbime më të mira të infrastrukturës komunale për qytetarët. Komunat e audituara në përgjithësi kanë aplikuar rregullat dhe kanë ndjekur procedurat e prokurimit në fuqi, ashtu siç parashihet edhe me kërkesat e Grantit.

Megjithatë, menaxhimi i projekteve dhe fondeve nga Granti kishte nevojë për vëmendje më të madhe duke filluar nga vendosja e prioriteteve, realizimi i projekteve dhe rezultatet e arritura. Procesi i prokurimit ka nevojë të përmirësohet sidomos në pikat si: përfshirja e projektit në planin e prokurimit publik, përlllogaritja e përafërt e vlerës së parashikuar të kontratës, evidentimi i pozicioneve të ndryshuara dhe trajtim i drejtë i Operatoreve Ekonomik në proceset tenderuese.

Gjysma e projekteve të audituara nuk ishin realizuar me kohë dhe nuk ishin në shfrytëzim të plotë nga qytetarët. Vonesat në realizimin e projekteve ndërldheshin me mos shpronësimet me kohë të pronave private dhe pengesat për shkak të zhvillimit të dy projekteve në kohë dhe zonë të njëjtë.

Me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të Grantit të Performancës Komunale, ishin dhënë pesë (5) rekomandime për institucionet përgjegjëse.

- **Sistemi për menaxhimin informativ të lëndëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës**

Fokusi i auditimi ishte vlerësimi i sigurisë dhe administrimit të sistemit informativ për menaxhimin e lëndëve, nëse është duke ofruar informacione të besueshme, me integritet dhe në kohë. Subjekt i auditimit ishin; Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), si dhe Gjykata Themelore dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Ferizaj, për qëllime të sistemit.

Rezultatet e auditimit tregojnë që, pavarësisht zhvillimeve dhe avancimeve të vazhdueshme në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Lëndëve në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, institucionet përgjegjëse kanë disa mangësi në qeverisjen e teknologjisë së informacionit dhe në sigurinë e sistemeve të informacionit. Ka mangësi në hartimin dhe monitorimin e strategjisë së TI-së, krijimin e strukturës, politikave dhe procedurave të TI-së, zhvillimin dhe përdorimin e sistemit informativ për menaxhimin e lëndëve, si dhe në kontrollet për siguri të informacionit dhe planit për vazhdimësi të sistemit të informacionit. Këto mangësi mund të ndikojnë në administrimin jo të mirë të sistemeve të informacionit dhe pasqyrimin jo të saktë të efikasitetit, transparencës dhe në planifikimin e burimeve të nevojshme në gjykata/prokurori.

Çështjet e identifikuara gjatë auditimit tregojnë se ekziston nevoja për përmirësime në qeverisjen dhe sigurinë e sistemeve të informacionit, nëpërmjet të cilave

mundësohet menaxhimi lëndëve në gjykatë/prokurori. Për këtë qëllim ishin dhënë 16 rekomandime për KGJK dhe 14 për KPK.

- **Sistemet elektronike për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve në AZhB-MBPZHR**

Fokusi i auditimi ishte të vlerësojë nëse sistemet e informacionit për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve bujqësore kanë arritur qëllimin për lehtësimin e menaxhimit dhe transparencës së aplikacioneve, si dhe nëse kanë siguruar integritetin, vlefshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave gjatë përpunimit të tyre. Fushëveprim i auditimi ka qenë Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Rezultatet e auditimit tregojnë se ka mangësi në qeverisjen e teknologjisë së informacionit si dhe këto sisteme nuk kanë arritur të sigurojnë integritetin, vlefshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave që përmbajnë.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë nuk kishte të hartuar planin strategjik apo strategjinë të teknologjisë së informacionit, politikat dhe procedurat e teknologjisë së informacionit të cilat do të përcaktonin se si teknologjia e informacionit do të mbështeste nevojat e institucionit.

Në aplikacionet që përdor Agjencia nuk kishte të vendosura kontrole për t'u siguruar që ato pranojnë vetëm të dhëna të autorizuara, të sakta dhe të plota. Po ashtu, mangësi janë vërejtur edhe në sigurinë e sistemeve të informacionit të cilat rrezikojnë që infrastruktura dhe sistemet të jenë të pa sigurta dhe të cenueshme kundrejt gabimeve dhe keqpërdorimeve të mundshme.

Rrjedhimisht, aplikacionet që ka në shfrytëzim Agjencia nuk i përmbajnë standardet e kërkuara që të menaxhojnë në mënyrë efikase proceset për shpërndarjen e granteve dhe subvencioneve bujqësore.

Çështjet e identifikuar gjatë auditimit tregojnë se ekziston nevoja për përmirësime rreth menaxhimit dhe qeverisjes së teknologjisë së informacionit brenda organizatës. Për këtë qëllim ishin dhënë 16 rekomandime për Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë.

- **Vendimmarrjet lidhur me strukturën organizative dhe Apex dega në Kosovë – Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut –KOSTT**

Fokusi i auditimi ishte të vlerësojmë nëse vendimet lidhur me strukturën organizative të Operatorit të Transmisionit, Sistemit dhe Tregut sh.a (tutje KOSTT) janë sipas kriterëve të vendosura në legjislacion, statutit të ndërmarrjes, rregulloreve dhe akteve tjera që rregullojnë organizimin e menaxhimit të ndërmarrjeve publike në vend dhe nëse vendimet e APLEX-it dega në Kosovë kanë qenë në pajtim me aktet e saj dhe në drejtim të arritjes së rezultateve më të mira. Ky auditim është kryer

bazuar në kërkesën e Kuvendit të Kosovës. Fushëveprimi ishte në KOSTT dhe Alpex dega në Kosovë që klasifikohet si auditim i performancës.

Rezultatet e auditimit kanë treguar se KOSTT ka një strukturë organizative përmes së cilës përshkruan nivelet hierarkike, funksionet e njësisë organizative dhe aktivitetet e kompanisë.

Megjithatë, auditimi ka identifikuar disa mangësi gjatë vendimmarrjes lidhur me strukturën organizative dhe proceseve përcjellëse të saj. Në veçanti, mangësitë kanë të bëjnë me themelimin e pozitave të reja jashtë strukturës organizative, mungesën e një analiz dhe arsyeshmërie të mirëfilltë lidhur me nevojën për ndryshime, si dhe me avancimin në pozita të ndryshme në KOSTT duke anashkaluar procedurat e parapara për mbulimin e këtyre pozitave.

Më tutje, lidhur me vendimet e ALPEX dega në Kosovë, vendimmarrja në përgjithësi ishte e bazuar në harmoni me marrëveshjen e aksionarëve të KOSTT.sh.a dhe OST.sh.a dhe në përputhje me Statutin e ALPEX.sh.a. Ndërlidhur me këtë, mungesa e një procedure formale për zgjedhjen dhe emërimet e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të ndryshëm ka ndikuar që në raste të caktuara përzgjedhja e kandidatëve për pozita menaxheriale të bëhet pa procese transparente dhe konkurruese.

Me qëllim të përmirësimit të procesit vendimmarrës për strukturën organizative dhe vendimet lidhur me ALPEX, ishin dhënë pesë (5) rekomandime për KOSTT.

Auditimet e veçanta të pajtueshmërisë

Gjatë vitit 2021, janë publikuar (2) dy raporte të auditimit të pajtueshmërisë, vijim:

- **Dhënia e pëlqimeve për ndërtim/dhënia në shfrytëzim të pronës së NP KOSTT sh.a nga palët e tjera, marrëveshjet e lidhura për blerje të energjisë së prodhuar në mes të NP KOSTT sh.a dhe kompanive që operojnë me burime të ripërtëritshme**

Fokusi i auditimit ishte të vlerësojmë nëse dhënia e pëlqimeve apo refuzimi i tyre për shfrytëzim të pronave të Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut sh.a (tani e tutje: KOSTT) për palët tjera, janë në harmoni me kriteret e përcaktuara në ligjet përkatëse, standardet dhe në pajtim me statutin e ndërmarrjes, rregulloret e brendshme dhe akte tjera. Rrjedhimisht do të vlerësohet edhe menaxhimi i proceseve. Objektivi tjetër i auditimit ishte vlerësimi i dhënies së pronave (dyqaneve dhe fibrave optik) me qira. Ky auditim kishte në fokus vlerësimin e të gjitha përgjigjeve (pëlqime/refuzime) lidhur me dhënien e pëlqimeve për ndërtim/shfrytëzim të pronave të KOSTT-it nga palët e tjera nga 01 janar 2015 e deri në fund të gushtit 2021.

Rezultatet e auditimit për pjesën e parë kanë nxjerrë në pah disa mangësi, si menaxhimi i procesit të dhënies së përgjigjeve (pëlqimet/refuzimet) për palët ishte

përcjellë me vonesa kohore në trajtimin e lëndëve, dhe mos aplikim të tarifave për institucionet publike.

Zona e sigurisë të transmisionit energjetik ishte cenuar nga ndërtimet e periudhave të mëhershme që ishin kryesisht ndërtime ilegale, por që ky fenomen vazhdon të ndodhë ende me një intensitet më të ulët. Megjithatë, kishte raste kur edhe përkundër përcaktimit të kushteve teknike nga KOSTT, ato nuk ishin respektuar, me ç'rast ndërtimet dhe zhvendosjet e shtyllave ishin brenda zonës së sigurisë (ku ndalohen ndërtimet).

KOSTT ka dhënë përgjigje (pëlqime/refuzime) dhe ka përcaktuar kushtet teknike për zhvendosjen e shtyllave dhe kabllimin tokësor duke u bazuar në standardet ndërkombëtare, por që nuk kishte rregullore të brendshme. Një draft rregullore është në proces hartimit, por nuk ishte e aprovuar nga Bordi. Për adresimin e këtyre çështjeve kemi dhënë pesë (5) rekomandime përkatëse.

Për pjesën e dytë, rezultatet bazuar në mostrat e audituara tregojnë se kontrollet e brendshme të vendosura nga KOSTT Sh.A. në lidhje me këtë fushë kanë funksionuar në mënyrë efektive.

- **Fondeve për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore të Dhomave të specializuara**

ZKA ka kryer auditimin e Fondeve për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore të Dhomave të specializuara. Auditimi ishte me kërkesë të menaxhmentit të Ministrisë së Drejtësisë, dhe mbulon periudhën e shpenzimeve të këtyre fondeve prej 21 shkurt 2021 deri më 20 shtator 2021.

Fokusi i auditimit ishte programi për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial nga Dhomat e Specializuara. Buxheti i ndarë për këtë 16,218,892€, i cili ishte shpenzuar 4,513,008€ apo 28%.

Shpenzimet kryesisht ishin për mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes juridike për personat e akuzuar për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara në vlerë 4,462,797€, si dhe për mbështetjen financiare për anëtarët e ngushtë të familjes së personave të akuzuar në vlerë 18,309€, derisa pjesa tjetër prej 31,902€ ishin për paga dhe mallra e shërbime të Njesisë për koordinim në kuadër të MD-së që klasifikohet si auditim i rregullsisë.

Rezultatet e auditimit - marrë për bazë kërkesat e ligjit nr. 03/L-178 për klasifikim të informacionit dhe verifikimin e sigurisë, raporti i auditimit nuk është publikuar, por i është dërguar ministrisë përgjegjëse dhe Komisionit Parlamentare për Mbikëqyrje të Financave Publike si dhe Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere.

5. Kontrolli i cilësisë

Qëllimi i auditimit është që t'i ofrojë siguri palëve të interesit dhe publiku të gjerë për cilësinë e raporteve financiare dhe menaxhimit financiar.

Rëndësia e kryerjes së auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, ka të bëjë që auditimi të:

- sigurojë cilësi në auditimet e kryera;
- forcojë besueshmërinë e palëve të interesit në raportet e auditimit;
- rrisë transparencën e procesit të auditimit;

Doracakët e auditimit me të cilët operon ZKA, rregullojnë metodologjinë e kryerjes së auditimeve dhe ofrojnë informata dhe udhëzime të mjaftueshme për t'i ndihmuar auditorët gjatë procesit të auditimit të punojnë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), parimet e INTOSAI, dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) si dhe udhëzimet të përshkuara në Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI (KDPI).

Cilësia e auditimit përfshin një mjedis, i cili rritë sigurinë që auditimet e kryera të jenë cilësore dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.

ZKA punon drejt sigurimit të vazhdueshëm të produkteve dhe shërbimeve të auditimit me cilësi të lartë e që përmbushin pritshmëritë e palëve të interesit në mënyrën më efikase dhe me kosto efektive. Kjo arrihet përmes një shkallë të lartë e integritetit, llogaridhënies dhe kompetencës. Cilësia duhet të jetë e pranishme në të gjitha fushat e veprimtarisë së ZKA.

Kontrolli i cilësisë përbëhet nga sisteme dhe praktika të krijuara për të siguruar që ZKA publikon raporte që janë të përshtatshme për rrethanat, dhe në përputhje me standardet dhe legjislacionin në fuqi.

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në kryerjen e auditimit është thelbësore për të ruajtur besimin në sigurinë që ajo ofron Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Rritja e cilësisë së auditimeve është synim i vazhdueshëm, jo vetëm në zbatimin e standardeve dhe kërkesave në fushën audituese, por që auditimet e realizuara t'i ofrojnë publikut dhe Kuvendit në kohën e duhur informatat e besueshme mbi administrimin dhe përdorimin e fondeve dhe pasurisë publike.

Në të gjitha auditimet që kryhen nga ZKA, kontrolli i cilësisë kryhet dhe sigurohet në disa nivele, duke u nisur nga udhëheqësit e auditimit dhe ndihmësit e Auditorit të Përgjithshëm. Përveç kësaj ZKA-ja ka të themeluar edhe Departamentin për Metodologji dhe Departamentin për Sigurimin e Cilësisë në Auditim, me qëllim të


ngritjes së cilësisë së auditimeve në një nivel sa më të lartë. Ky departament, i cili vepron në pajtim me SNISA-t 140 (Kontrolli i cilësisë), kryen rishikimin e auditimeve të realizuara.

Përzgjedhja e auditimeve për rishikim nga ky departament, gjatë vitit 2021 (për auditimet e sezonit auditues 2020/2021) ka pasur parasysh madhësinë, kompleksitetin e auditimeve, si dhe duke konsideruar mbulueshmërinë e të gjitha ekipeve të auditimit në procesin e rishikimit të dosjeve të auditimit.

Për sezonin 2020/2021 janë kryer 34 rishikime të auditimeve të rregullsisë, prej tyre për fazën e planifikimit ishin kryer 27 rishikime të cilësisë, ndërsa 12 rishikime për fazën e ekzekutimit dhe raportimit.

Për sezonin 2020/2021 janë kryer/proces 48 rishikime të auditimeve të rregullsisë, prej tyre për fazën e planifikimit janë kryer 30 rishikime të cilësisë, ndërsa 18 rishikime janë planifikuar për fazën e ekzekutimit dhe raportimit.

Sa i përket auditimeve të performancës, monitorimi dhe kontrolli i cilësisë është një proces që zbatohet në çdo auditim. Fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të auditimit janë subjekt i rishikimit në të gjitha nivelet menaxheriale. Rishikimi kolegjial për memorandumun e parastudimit dhe draft-raportin e auditimit bëhet nga anëtarët e emëruar (auditorë me përvojë) brenda divizionit. Për disa nga temat janë angazhuar këshilltarë të jashtëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë (SNAO).



Kapitulli III

Menaxhimi Financiar dhe
Administrativ

Kapitulli III

Menaxhimi Financiar dhe Administrativ

1. Menaxhimi financiar

ZKA-ja është institucion i pavarur, i cili financohet nga buxheti i shtetit dhe si i tillë duhet të menaxhohet dhe shpenzohet me një përgjegjësi dhe llogaridhënie të lartë. Bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin 2021, mjetet e ndara për ZKA-në ishin në shumë prej 2,795,576€. Buxheti ishte i ndarë në katër kategori ekonomike: Paga dhe mëditje, Mallra dhe shërbime, Shërbime komunale dhe Investime kapitale.

Përgjatë vitit fiskal 2021 ka pasur disa ndryshime buxhetore si rrjedhojë e rishikimit dhe vendimeve të qeverisë, si në vijim:


- Buxheti fillestar për vitin 2021 për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte në vlerë prej 2,087,841€. Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Vendimit 11/52 të datës 29.12.2021, për të mbuluar nevojat e kësaj kategorie ka ndarë mjete shtesë në shumë prej 104,598.25€, Buxheti final për këtë kategori ishte 2,192,439€.
- Buxheti fillestar për vitin 2021 për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve ishte në vlerë prej 605,235€. Përmes rishikimit buxhetor dhe Vendimeve të Qeverisë, buxheti është reduktuar në shumë prej 99,696€. Buxheti final për këtë kategori në fund të vitit ishte 510,164€ duke përfshirë të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak.
- Buxheti fillestar për vitin 2021 për kategorinë e shërbimeve komunale ishte në vlerë prej 50,000€. Përmes rishikimit buxhetor dhe Vendimeve të Qeverisë, buxheti është reduktuar në shumë prej 13,714.66€. Buxheti final për këtë kategori ishte 36,285€.
- Në kategorinë e Investimeve kapitale, ndarja buxhetore ishte në vlerë prej 52,500€ për dy (2) projekte kapitale.

Buxheti final në fund të vitit ishte **2,791,388€**.

Tabela 6. Shpenzimi i buxhetit përgjatë tri viteve 2021-2019 (në EUR `000)


Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	%
2021				
Buxheti i përgjithshëm	2,796	2,791	2,750	99%
Pagat dhe mëditjet	2,088	2,192	2,192	100%
Mallrat dhe shërbimet	605	510	475	93%
Shërbimet komunale	50	36	34	92%
Investimet kapitale	53	53	49	93%
2020				
Buxheti i përgjithshëm	3,115	3,084	3,041	99%
Pagat dhe mëditjet	2,078	2,216	2,216	100%
Mallrat dhe shërbimet	692	564	523	93%
Shërbimet komunale	45	32	30	96%
Investimet kapitale	300	272	272	100%
2019				
Buxheti i përgjithshëm	3,358	2,966	2,894	98%
Pagat dhe mëditjet	2,098	2,125	2,125	100%
Mallrat dhe shërbimet	723	660	615	93%
Shërbimet komunale	50	35	33	95%
Investimet kapitale	487	147	122	83%

Grafiku 4. Shpenzimet nëpër kategori ekonomike nëpër vite 2021-2019



Gjatë viti 2021 buxheti është shpenzuar në vlerë prej 2,750,000€, apo 99%.


Grafiku 5. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë vitit 2021



Grafikun 5. pasqyron shpenzimin e buxhetit të ZKA-së gjatë vitit 2021. Nga kjo vërehet se shumica me e madhe e buxhetit shpenzohet në kategorinë e pagave dhe mëditjeve prej 80%, derisa mallrat dhe shërbimet prej 17%. Kategoritë tjera si, shpenzimeve komunale (1%) dhe investimeve kapitale (2%).

- Buxheti fillestar në kategorinë e paga dhe mëditje për vitet 2019, 2020 dhe 2021, siç shihet edhe në tabelën 6, kishte pësuar rritje në raport me buxhetin final. Rritja e buxhetit final për këtë kategori është bërë me vendime të qeverisë. ZKA-ja në vazhdimësi kishte shpenzime më të larta se buxheti i miratuar me ligj dhe për pasojë në çdo fund vit, kjo kategori ekonomike ka rezultuar me deficit buxhetor. Deficiti buxhetor ishte shkaktuar nga angazhimi i këshilltarëve të jashtëm, promovimi i stafit mbështetës në pozita auditorë, ndërmarrja e procedurave të promovimeve të brendshme dhe rekrutimi i personelit edhe përkundër që nuk kishte buxhet për t'i financuar këto shpenzime.
- Me ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2021, numri i miratuar i personelit ishte për 173 pozita, mirëpo edhe përkundër kësaj, nuk ishte miratuar buxhet i mjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet për këtë kategori. Për të parandaluar trendin e menaxhimit me deficit buxhetor, dhe për të vendosur kontrolle adekuate, Auditorja e Përgjithshme ka rishikuar strukturën organizative, duke vendosur akte normative të përshtatshme me Institucionet Supreme të Auditimit, rrjedhimisht kësaj janë shuar pozitat këshilltarë, janë fuzionuar disa departamente mbështetëse, është kryer nivelizimi i pagave në kuadër të institucionit, duke eliminuar shtesat në pagë, si dhe me kërkesë të Auditorës së Përgjithshme, drejtuar Kuvendit të Kosovës, është miratuar ulja e pagës për vendin e punës Auditor i Përgjithshëm. Këto veprime kanë rezultuar që shpenzimi për paga dhe mëditje për vitin 2021 të jetë më ulët se shpenzimi i vitit 2020.
- Kategoria e **mallrave dhe shërbimeve**, ka ulje të shpenzimeve si rrjedhojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19;
- Kategoria e **shërbimeve komunale**, është në vlera të përafërta dhe nuk ka ndonjë ndryshim domethënës;
- Kategoria e **Investimeve kapitale**, krahasuar me vitet paraprake, vërehet se investimet kapitale janë reduktuar në masë, si rrjedhojë e përfundimit të projektit kapital “Softueri për Sistemin Informativ i Teknologjisë së Auditimit (SITA)” gjatë viti 2020.

Grafiku 6. Shpenzimet kryesore në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2021



Grafikun 6. pasqyron shpërndarjen e zërave kryesor të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, si vijim:

- Shpenzimin më të lartë në këtë kategori e përbën qiraja e objektit (168,008 apo 35.4%);
- Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe sigurimit të objektit, mirëmbajtje të teknologjisë Informative dhe të veturave zyrtare (96,878 apo 20.4%);
- Pajisjet dhe furnizimet për zyrë (42,484 apo 8.9%);
- Shpenzimet intelektuale dhe këshillëdhënëse, përfshinë angazhimin e kompanive të jashtme të auditimit për auditime të rregullsisë, e përbënë (39,948 apo 8.4%) të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

2. Pasuritë

Vlera e pasurive kapitale në fund të vitit 2019 ishte 180,760€, gjatë vitit 2020 kjo vlerë është rritur prej 413,958€, si rezultat i zbatimit të kontratës për zhvillimin e softuerit për Sistemin Informativ të Teknologjisë së Auditimit (SITA), derisa në fund të vitit 2021 vlera neto e pasurive kapitale të cilat janë në pronësi të ZKA-së arrin vlerën prej 419,539€.

Vlen të theksohet se ZKA operon me 11 vetura zyrtare për kryerjen e proceseve audituese, 7 prej të cilave janë plotësisht të amortizuara, pra vlera neto në fund të 2021 është zero.

Tek pasuritë kapitale (mbi 1,000€) paraqitet një ngritje të vlerës neto, derisa tek pasuritë jo kapitale (nën 1,000 €) ka ndodhur e kundërta, pra ka ulje të vlerës neto. Vlera neto e këtyre pasurive në fund të vitit 2019 ishte 127,145€, në fund të vitit 2020 kjo vlerë ishte ulur në shumë 110,322€, derisa në fund të vitit 2021 vlera e këtyre pasurive kishte shumë prej 91,183€. Ulja e vlerës neto të pasurive jo kapitale (nën 1,000 €) është si rezultat i amortizimit të tyre si dhe investimeve/blerjeve të kufizuara gjatë këtyre viteve.

Gjatë vitit 2021, ZKA-ja ka përfunduar procesin e vlerësimit të pasurive nga komisioni përkatës që ka rezultuar me identifikimin e një numri të caktuar të pasurive si pasuri jashtë përdorimit.

3. Burimet Njerëzore

Njësia e burimeve njerëzore ofron përkrahje profesionale për të gjithë punonjësit e ZKA-së, rrjedhimisht ushtrimi i veprimtarisë është përputhje të plotë me rregullativën ligjore në fuqi dhe me udhëzuesit dhe politika e INTOSAI dhe EUROSAI, ku ZKA është anëtare më të drejta të plota.

ZKA në fund të vitit 2021 kishte 164 punonjës. Struktura e personelit ndahet në ekipin menaxhues, auditorët dhe pjesa e punonjësve që ofrojnë shërbime profesionale mbështetëse. Struktura e numrit të përgjithshëm të personelit përbehet prej 82% personel auditues (përfshirë pozitat drejtuese), dhe 18% janë punonjës të shërbimeve të tjera profesionale mbështetëse.

Gjatë vitit 2021, ZKA-ja ka angazhuar tre (3) punonjës të rinj, derisa marrëdhënien e punës e kanë shkëputur dhjetë (10) punonjës, ku përfshihen tri (3) dorëheqje, dy (2) pensionime dhe pesë (5) vende të cilave i'u kishte përfunduar mandati. Si rrjedhojë, këto vende të lira pune pritet të plotësohen gjatë vitit 2022.

Tabela 9 paraqet të dhënat rreth nëpunësve, ku përfshihet numri i përgjithshëm i nëpunësve, përqindja e gjinisë femërore, moshë mesatare në ZKA, numri i nëpunësve nga komunitetet si dhe përqindja e lëvizjeve/largimeve të nëpunësve.

Tabela 7. *Ndryshimet në personelin e ZKA-së, përgjatë tri viteve të fundit*

Viti	Numri i personelit në fund të vitit	Personeli nga gjinia femëror (%)	Mosha Mesatare (vite)	Numri i personelit nga komunitetet	Lëvizja e personelit %
2021	164	52.4%	42.7	4	4.27
2020	171	52.6%	41.7	4	1.75
2019	171	53.2%	42.2	4	1.75

Të dhënat pasqyrojnë që lëvizjet e personelit në 3 vitet e fundit ishin të baraspeshuara (1-4%) e numrit të përgjithshëm të stafit që paraqet një element të rëndësishëm në ruajtjen e stafit profesional në proceset audituese. Për sa i përket strukturës gjinore, ZKA qëndron mirë pasi mbi 50% e nëpunësve i përkasin gjinisë femërore ku përfaqësohen edhe në pozita larta drejtuese.

Mosha mesatare e nëpunësve ka një rritje të lehtë nga viti i kaluar, 77% e nëpunësve të ZKA-së janë të moshës së mesme prej 31 deri në 50 vjet, të moshës prej 51 deri në 65 vjet janë 18%, kurse të moshës nën 30 vjet janë 5% e nëpunësve.

Sa i përket përfshirjes së komuniteteve në ZKA, edhe përkundër përpjekjeve tona të vazhdueshme për të tërhequr më shumë kandidatë nga komunitetet, interesimi nga kjo kategori mbetet ende i vogël. Përfaqësimi i komuniteteve në ZKA është në 2.5%.

Gjatë vitit 2021, 10 punonjës të ZKA-së janë promovuar në detyrë, kryesisht në fushën e auditimit, derisa gjatë këtij viti vlen të theksohet se është kryer edhe procesi i riorganizimi brendshëm, që si rrjedhojë pozitën drejtuese në fushën e auditimit janë reformuar në tërësi. Drejtuesit e auditimit tashmë kanë vende pune të qëndrueshme me akt të marrëdhënies së punës të zgjedhur përmes procedurës së hapur, transparente dhe konkurruese, që në krahasim me vitet paraprake, për këtë kategori aplikohet procedura e emërimit 1 vjeçar të drejtpërdrejtë nga Auditori i Përgjithshëm.

Tabela 8. *Pozitat drejtuese sipas gjinisë në të gjitha funksionet*

Viti	Gjithsej femra në pozita udhëheqëse (numër)	Përqindja %	Gjithsej meshkuj në pozita udhëheqëse (numër)	Përqindja %
2021	36	50	36	50
2020	35	49	37	51
2019	39	53	34	47

Tabela 10, paraqet strukturën udhëheqëse të ZKA-së në 3 vitet e fundit, ku përfshihen niveli i lartë drejtues (Ndihmës Auditor të Përgjithshëm) nga gjithsej 5 pozita prej tyre dy (2) femra dhe tre (3) meshkuj, nivel i mesëm (Drejtor Departamenti) nga gjithsej 22 pozita prej tyre shtatë (7) femra dhe pesëmbëdhjete (15) meshkuj, ndërsa niveli i ultë udhëheqës (Udhëheqës Ekipi) nga gjithsej 44 pozita prej tyre

njëzeteshtatë (27) femra dhe shtatëmbëdhjetë (17) meshkuj,. Përqindja në pozitat drejtuese sipas gjinive mbetet e ngjashme, sikurse e vitet e kaluar.

Pozitat audituese - Auditorët bëjnë pjesën më të madhe të nëpunësve të ZKA-së, kjo kategori është pjesa më e rëndësishme e institucionit tonë dhe si e tillë, vëmendje të veçantë i kushtohet aftësisë së tyre profesionale. Përgjatë viteve është investuar përmes formave të ndryshme të përkrahjes profesionale, si përmes ndjekjes së programeve të certifikimit ashtu edhe në mbajtjen e njohurive përmes edukimit të vazhdueshëm profesional. Tabela si më poshtë paraqet strukturën e auditorëve ndër vite.

Tabela 9. Pozitat audituese sipas viteve 2021-2019

Viti	Financiar & Pajtueshmëri			Performancë (Prokurim & TI)			Auditor Specialist
	Auditor Senior	Auditor	Auditor Junior	Auditor Senior	Auditor	Auditor Junior	
2021	66	21	15	13	4	8	6
2020	61	30	15	11	6	8	6
2019	63	29	16	8	8	9	5

Të dhënat pasqyrojnë se pozitat audituese, si në fushën e auditimit financiare/pajtueshmërisë ashtu edhe në atë të performancës, numri më i madh i auditorëve mban gradën profesionale auditor senior, që është tregues i rëndësishëm për pjekurinë profesionale të stafit auditues.

4. Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit

Zhvillimi profesional është objektiv kryesor dhe i vazhdueshme i ZKA-së, që nëpërmjet zhvillimit profesional trason rrugën e sigurtë për arritjen e objektivave strategjike në mënyrë profesionale në proceset audituese. Kjo qasje ka për qëllim që personeli ynë të ketë shkathhtësitë dhe kapacitetet e duhura për të përmbushur detyrat e përcaktuara në realizimin e objektivave audituese.

ZKA i ka kushtuar rëndësi certifikimit të stafit auditues dhe edukimit të vazhdueshëm profesional në hap me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Në skemën e certifikimit publik nëpër nivele janë certifikuar 98 auditorë, prej tyre 83 auditorë të certifikuar në sektorin publik, 11 auditorë të sektorit publik dhe 4 asistentë i auditorit në sektorin publik.

Për auditimet e performancës janë certifikuar 18 auditorë në kuadër të një programi për Zhvillimin e Kapaciteteve Institucionale ndërmjet SNAO dhe ZKA. Po ashtu, ZKA në fushën e Auditimeve në Teknologjisë të Informacionit janë 3 auditor të Certifikuar në IKAF dhe një (1) auditor është në proces të certifikimit.

Tabela 10. Auditorët e certifikuar nëpër nivele në skemat e certifikimit

Nivelet e certifikimit	Auditor i certifikuar i sektorit publik	Auditor i sektorit publik	Asistent i Auditorit i certifikuar i sektorit publik	Auditorët e certifikuar të TI-së.	Auditor i certifikuar i performancës
Numri i auditorëve	83	11	4	3	18

Përgjatë vitit 2021, trajnimet janë zhvilluar me një sistem të kombinuar përmes platformave online, qasjes fizike, seminareve virtuale dhe pjesëmarrjes nëpër konferenca të ndryshme. Kjo përfshin edhe pjesëmarrjen në trajnime në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP), të cilën ZKA e ka të rregulluar përmes dy shoqatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Personeli ynë, zhvillon aftësitë dhe kapacitetet e tyre edhe përmes punës së përditshme, duke përdorur ekspertizën dhe këshillë dhënien e kuadrit profesional të brendshëm. Gjatë vitit 2021, janë zhvilluar një mori aktivitete të ndryshme të trajnimit, mirëpo ato që veçohen janë:

- Programi “Udhëheqësit e rinj të Institucioneve Supreme të Auditimit”;
- Certifikimi i auditorëve e performancës, i zhvilluar përmes bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë;
- Trajnimet për metodologjinë e përditësuar të auditimit;
- Trajtime intensive online me qëllim të qëllim të familjarizimit me kërkesat e doracakut dhe letrave të punës të përditësuara Po ashtu, në kuadër të këtij projekti janë mbajtur edhe trajnime të veçanta për ekipet e përzgjedhura si pilot dhe për personelin e departamentit për metodologji dhe cilësi;
- Trajtime për përdorimin e sistemit elektronik të auditimit (SITA).
- Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP) i organizuar me shoqata profesionale, me qëllim të përmbushjes së orëve të nevojshme për mbajtjen dhe përditësimin e njohurive profesionale.
- Trajnimi “Prokurimi sipas rregullave të Bankës Botërore”; dhe
- Trajnimi për zhvillimin e aftësive në prezantim publik. Në kuadër të projektit “Promovimi i rolit të Auditorit të Përgjithshëm/ZKA-së në Kosovë”.




Foto 1. Trajnimet për stafin e ZKA-së.

Trajnimet janë përkrahur nga shumë partnerë dhe donatorë me të cilët ZKA bashkëpunon në fushën e zhvillimit profesional, ku përfshihen, Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, Banka Botërore, Bashkimi Evropian, Ambasada e Mbretërisë Holandeze, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, etj.

5. Mirëqenia e personelit

Përgjatë tërë vitit 2021, ne kemi arritur t'i përgjigjemi të gjitha masave të shëndetit publik në vend, përkundër vështirësive dhe situatave të krijuar nga Covid'19. Në këto kohë të vështira të pandemisë COVID-19, ne kemi shfrytëzuar masat dhe praktikatat ekzistuese për luftimin e pandemisë, dhe kemi arritur t'i mundësojmë kushte për punë nga shtëpia gjithë stafit me qëllim që të kemi një mjedis të shëndetshëm dhe produktiv.

ZKA ka të themeluar një ekip për menaxhimin e situatës pandemike COVID-19, i cili përkujdeset për të siguruar se i gjithë personeli është i informuar me kohë lidhur me gjitha masat e ndërmarra nga institucionet kompetente për luftimin e pandemisë.

ZKA ka demonstruar një profesionalizëm të lartë për punë të balancuar në distancë me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara dhe përmbylljes së sezonit auditues në mënyrë të suksesshme dhe me raporte cilësore.

Situata pandemike e COVID-19 ka pasur një ndikim të theksuar në menaxhimin e proceseve audituese, prandaj fokusi për të realizuar detyrat dhe përgjegjësitë ishte përqendruar në përmbushjen e të gjitha objektivave të përcaktuara me planin vjetor të auditimit.

6. Shërbimet e përbashkëta

Në përputhje me strategjinë dhe objektivat e ZKA-së, departamenti për shërbime të përbashkëta, përmes divizioneve përkatëse, ofrojnë shërbime përkatëse për personelin e ZKA-së.

Divizionet përkatëse të këtij departamenti janë: divizioni për logjistikë, divizioni për administrim të dokumenteve zyrtare dhe divizioni për përkthime.

Divizioni për logjistikë ofron mbështetje të vazhdueshme për ekipet audituese, duke ofruar shërbime të transportit si dhe të përkrahjes përmes furnizimeve të materialeve të nevojshme për punë në zyrë. ZKA, disponon me njëmbëdhjetë (11) vetura zyrtare, shtatë (7) nga të cilat janë plotësisht të amortizuara. Po ashtu përmes sistemeve elektronike, E-Pasuria dhe SIMFK është bërë regjistrimi i të gjitha pasurive të blera gjatë vitit 2021 në sistemet përkatëse, barkodimi i tyre, inventarizimi, vlerësimi si dhe tjetërsimi i pasurive jashtë përdorimit.

Divizioni për administrimin e dokumenteve zyrtare në bashkëveprim me departamentin e TI-së ka vazhduar me menaxhimin/arkivimin elektronik të dokumenteve zyrtare. Përmes platformës elektronike, auditorët kanë qasje në dokumentet e arkivuara, të cilat janë të nevojshme për punët vijuese në auditim. Gjatë viti 2021, kjo njësi ka protokolluar 2,705 dokumente të ndryshme.

Divizioni për përkthime ofron shërbimin e përkthimit të dokumenteve zyrtare në gjuhën angleze dhe serbe, dhe anasjelltas, si dhe përkthimin e drejtpërdrejt në takimet dhe punëtoritë e organizuara nga ZKA.

Si rrjedhojë e numrit të kufizuar në kuadër të këtij divizioni, si dhe volumit të madh të nevojave për përkthim të dokumenteve, gjatë vitit 2021 është angazhuar një operator i jashtëm për ofrimin e përkrahjes në përkthimin e raporteve të auditimit.

7. Teknologjia informative

Departamenti për Teknologji së Informacionit në ZKA është përgjegjës për menaxhimin e tërë infrastrukturës së TI-së. Gjatë vitit 2021, ky departament vazhdimisht ka përkrahur personelin e ZKA-së që të arrijë të përmbush objektivat e përcaktuara vjetore. Situata e pandemike COVID 19, ka ndikuar që puna e kësaj njësie të zhvillohet në kushte të jashtëzakonshme, duke ofruar përkrahje për secilin ekip auditues. Sfidat ishin të natyrës komplet profesionale të fushës së TI-së, në mënyrë që të ofrohet kjo përkrahje, është rifreskuar infrastrukturën ekzistuese e TI-së, me qëllim të dhënies së shërbimeve më të mira dhe më efikase për auditorët e ZKA-së.

Për më tepër, gjatë vitit 2021 është investuar edhe në monitorimin dhe sigurinë e rrjetit të ZKA-së, me qëllim që të dhënat tona të jenë të sigurta nga sulmet e mundshme apo avaritë tjera eventuale.

Sfidë për ZKA në këtë fushë mbetet:


- kufizimi në përcjelljen e trendëve të cilat po ndryshojnë shumë shpejtë;
- përdorimi i teknologjisë cloud; dhe
- përdorimi i aplikacioneve të reja të cilat do të bëjnë më efikase punën në grup dhe më lehtë menaxhimin e projekteve.

8. Prokurimi

Në kuadër të aktiviteteve të prokurimit gjatë vitit 2021, ZKA në përputhje me Planin Vjetor të Prokurimit ka zhvilluar gjithsej 41 aktivitete prokurimi të cilat kryesisht kanë qenë për furnizime dhe kryerje të shërbimeve.

Duhet të theksuar se Njësia e prokurimit në përputhje me informimin zyrtar nga KRPP nga data 01/02/2021, ndërlidhur me plotësim/ndryshimin A01 - Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik (RRUOP), ka filluar në përdorim të dy moduleve të reja të sistemit të prokurimit elektronik “Modulin për menaxhim të kontratës” dhe “Modulin për vlerësim të performancës së kontraktuesve”.

Po ashtu, në përputhje me informimin zyrtar të KKRPP, prej 01/08/2021 njësia e prokurimit aplikon procedurat me vlera minimale përmes platformës elektronike E-prokurimi.



Kapitulli IV

Komunikimi dhe Bashkëpunimi me
Palët e jashtme

Kapitulli IV

Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e jashtme

1. Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit

ZKA-ja gjatë vitit 2021 ka pasur një komunikim të frytshëm me palët e interesit, dhe ka zhvilluar më tutje qasjen gjithëpërfshirëse, duke qenë nikoqire dhe pjesëmarrëse në shumë takime, punëtori e konferenca brenda dhe jashtë vendit.

Në rrafshin kombëtar është forcuar më tej partneriteti me komisionet parlamentare dhe organizatat e shoqërisë civile, ndërsa në rrafshin ndërkombëtar është avancuar bashkëpunimi në mes të Institucioneve Supreme të Auditimit përmes takimeve, punëtorive e aktiviteteve të tjera në kuadër të EUROSAT-t dhe INTOSAI-t.

Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës, është materializuar përmes punës me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere (KBPT).

Auditorja e Përgjithshme ka prezantuar në seancë plenare gjetjet dhe rekomandimet e Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2020, gjatë të cilës Kuvendi ka miratuar rekomandimet e KMFP-së për t'i kërkuar Qeverisë së Kosovës që të zbatojë të gjitha rekomandimet e dala nga Raporti Vjetor i Auditimit. Kuvend është shqyrtuar edhe Raporti Vjetor i Performancës i ZKA-së për vitin 2020.



Foto 2. Auditorja e Përgjithshme, prezantimi i RVA-së në Kuvend për vitin 2020.

Në kuadër të bashkëpunimit, ZKA-ja në vazhdimësi ka përgatitur për KMFP-në dhe KBPT-në informatat e nevojshme dhe përmbledhjet për raportet e auditimeve të kryera, si dhe u ka ofruar deputetëve informatat dhe këshillat e nevojshme në lidhje me raportet e auditimit që diskutohen në komisionet parlamentare.

Gjatë vitit 2021, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar 25 raporte të auditimit, prej tyre 6 të

ministrive, 7 të Ndërmarrjeve Publike, 9 të performancës, si dhe Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2020 dhe Raportin Vjetor të Performancës së ZKA-së për vitin 2020.

AP-ja ka mbajtur takime të veçanta me kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe drejtuesit dhe anëtarët e KMFP-së dhe KBPT-së, varësisht prej kërkesave dhe çështjeve audituese për t' i informuar dhe raportuar. Po ashtu në kuadër të bashkëpunimit, deputetet e Kuvendit (anëtarët e KMFP) kanë vizituar zyrat e ZKA-së ku janë pritur nga AP dhe përfaqësues të tjerë të ZKA-së duke i informuar mbi procesin e Auditimit, kontrollin e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë; sistemin elektronik për menaxhimin e auditimit- SITA; zhvillimin profesional, si dhe për bashkëpunimin me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit.

Takimet e AP-së me krerët shtetëror dhe ambasadorë - Bashkëpunimi me përfaqësuesit e lartë të institucioneve shtetërore ka vazhduar përmes komunikimit të rregullt dhe takimeve, ku janë prezantuar çështjet kryesore të auditimit për vitin 2020 dhe progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit.



Foto 3. Auditorja e Përgjithshëm në takim pune me Kryetarin e Kuvendit.

Auditorja e Përgjithshme, znj. Vlora Spanca, në muajin shtator është takuar me kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca nga i cili ka marrë mbështetje për punën e Zyrës Kombëtare të Auditimit, në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik.

Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, në muajin tetor është takuar me presidenten e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, e cila ka theksuar nevojën e përmbushjes së mandatit kushtetues e ligjor të ZKA-së, duke siguruar që paraja publike të menaxhohet si duhet.



Foto 4. Auditorja e Përgjithshme në takim pune me Presidenten e Kosovës.

Auditorja e Përgjithshme, zi kryeministrin z.Albin Kurti, i cili ka shprehur mbështetjen për punën e Zyrës Kombëtare të Auditimit në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik, si dhe përkushtimin për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, për përdorim efektiv, efikas dhe ekonomik të fondeve publike.



Foto 5. Auditorja e Përgjithshëm në takim pune me Kryeministrinë e Kosovës.

Brenda kompetencave institucionale, kujdes i veçantë i është kushtuar bashkëpunimit profesional me Thesarin. Komunikimi i rregullt ndërmjet dy institucioneve ka bërë që të evidentohen me kohë dhe të shmangen një sërë gabimesh në Raportimin Financiar të OB-ve.

Auditorja e Përgjithshme, znj.Vlora Spanca, është takuar edhe me Shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë z.Tomáš Szunyog, si dhe me ambasadorin e Suedisë në Kosovë, z.Karin Hernmarck Ahliny.

Takimet tjera- bashkëpunim të mirë me institucionet e tjera vendore e ndërkombëtare në Kosovë, Auditorja e Përgjithshme ka mbajtur takime me:

- Avokatin e Popullit të Kosovës
- Komisioneren për Informim dhe Privatësi
- Shefin e misionit të FMN-së në Kosovë
- Shefen e Zyrës së UN Women në Kosovë
- Përfaqësuesit e SIGMA-s
- Drejtoreshën e re të HELVETAS Swiss Intercooperation në Kosovë
- Drejtorin e Departamentit të Demokratizimit të OSBE-së
- Përfaqësuesit nga Projekti SAEK III në kuadër të UNDP-së në Kosovë dhe
- Përfaqësuesit e USAID-it dhe projektit USAID TEAM



Foto 6. Auditorja e Përgjithshme në takim pune me Shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë.

Pjesëmarrja e AP-ve në punëtori e aktivitete të ndryshme vendore, si:

- Në tryezën “Ndikimi i subvencioneve dhe granteve në prodhimin bujqësor”;
- Në ngjarjen e organizuar nga USAID në bashkëpunim me KRPP-në, me rastin e fillimit të zbatimit të platformës e-Mësimi për auditimin e prokurimit publik;
- Në aktivitetin “Arritjet dhe sfidat në prokurim publik në Kosovë”

- Në punëtorinë e përvitshme

“Ngritja e performancës së Organizatave Buxhetore dhe zbatimi i rekomandimeve të dala nga Raporti Vjetor i Auditimit”.

2. Komunikimi me mediat, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe palët të tjerë

Gjatë vitit 2021, ZKA-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë partneritetit me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe mediat, si dhe komunikimit me qytetarë. Ky komunikim është avancuar edhe përmes takimeve të ndryshme, prezantimit publik të raporteve të auditimit të performancës, konferencave, vizitave nëpër institucione akademike.

Bashkëpunimi me OSHC-të dhe Shoqatat Profesionale - Në kuadër të takimeve periodike dhe me qëllim të forcimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe shoqatat profesionale, ZKA-ja ka mbajtur tryezën me temën “Fuqizimi i ndikimit të Auditimit të Jashtëm përmes bashkëpunimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit me organizatat e shoqërisë civile”.



Foto 7. Auditori i Përgjithshëm në takim pune me OSHC-të.

Auditorja e Përgjithshme, ka takuar drejtorët Ekzekutiv të Institutit për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF) dhe Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK), me qëllim të rritjes së bashkëpunimit të vazhdueshëm për ngritjen profesionale të auditorëve të ZKA-së.

Bashkëpunimi me institucionet akademike - Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në muajin shkurt kanë mbajtur seminarin me temën "Auditimi dhe sfidat në realitetin e ri në Kosovë".

Gjatë muajit mars janë vizituar edhe kolegjet AAB dhe UBT, ku është mbajtur ligjëratë me temën "Auditimi i jashtëm në Kosovë, të arriturat, sfidat dhe ndikimi i auditimit për menaxhim më të mirë të financave publike". Përveç kësaj, këto vizita kanë pasur për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe kolegjeve private në fushën e auditimit, shkëmbimet e ndihmës profesionale e akademike, si dhe të angazhimit të studentëve në punë praktike.

Vlerësimet për ZKA-së nga palët e jashtme për 2021 - Raporti i Bankës Botërore "Indeksi i Pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit" është vlerësuar në mesin e 17 Institucioneve Supreme të Auditimit në botë. Procesi i vlerësimit ka përfshirë 118 vende të botës dhe është bazuar në 10 indikatorë të pavarësisë, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe praktikrat e mira audituese.

Raporti Kombëtar i Monitorimit nën projektin rajonal WeBER 2.0 të Grupit për Studime Juridike dhe Politike ka evidentuar se ZKA ka shënuar progres në fushën e komunikimit me publikun.

Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2021, ka vlerësuar arritjet e ZKA-së, në veçanti anëtarësimin në EUROSAI si dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile për rritjen e ndikimit të punës audituese.

ZKA, rëndësi të veçantë i është kushtuar vënies në dispozicion të informatave të kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile, mediave dhe qytetarëve si dhe avancimit të komunikimit në rrjetet sociale. Puna dhe rezultatet e auditimit kanë qenë më afër publikut me rritjen e prezencës së ZKA-së në media, duke u botuar mbi 1.080 artikuj për raportet e auditimit dhe aktivitetet e AP-së.

Vlen të theksohet se web faqja e ZKA-së, si burimi kryesor i informacionit është përditësuar në vazhdimësi duke i ofruar qytetarëve qasje në të dhëna për raportet e auditimit. Brenda vitit janë regjistruar mbi 202,911 vizitorë.

Debatet nëpër Komuna - Me qëllim të rritjes së ndikimit të auditimit të jashtëm dhe rritjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm nga komunat e Kosovës janë mbajtur pesë (5) debate në të cilat ka marrë pjesë Menaxhmenti i ZKA-së, dhe në prezencë të kryetarit të komunës, të këshilltarëve komunal, të përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të mediave është diskutuar për progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditimit.



Foto 8. Përfaqësuesit e ZKA-së në debat në komunën e Vushtrrisë.

Në kuadër të Projektit me USAID -TEAM për t'i ndihmuar komunave që t'i zbatojnë rekomandimet e auditorit, gjatë muajit gusht/shtator, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) ka organizuar serinë prej pesë (5) debateve në komunat; Suharekë, Vushtrri, Ferizaj, Pejë dhe Prizren. Këto debate kanë pasur për qëllim ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e raporteve të auditimit dhe zbatimin e rekomandimeve.

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere dhe Marrëveshjet Bilaterale

Zyra Kombëtare e Auditimit është anëtare me të drejta të plota në dy organizatat kryesore të auditimit: INTOSAI dhe EUROSAI, ku gjatë vitit 2021 është fokusuar në ruajtjen e marrëdhënieve dhe avancimin e bashkëpunimit me organizatat homologe në rajon dhe më gjerë. Për më tepër, Menaxhmenti i ZKA-së ka marrë pjesë në Kongresin e XI të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI).

Projekti i Binjakëzimit në mes të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës dhe asaj të Polonisë - Projekti i Binjakëzimit "Fuqizimi i mëtejshëm i ndikimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit" i cili është financuar nga Bashkimi Evropian dhe është zbatuar nga Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë gjatë këtij viti është përmbyllur me sukses, përveç AP-së prezent ishte presidenti i Institucionit Suprem të Auditimit të Polonisë, Marian Banaś dhe Zëvendës shefja e Bashkëpunimit në Zyrën e Bashkimit Evropian në Prishtinë, Hillen Francke.

Objektiv e projektit të binjakëzimit ishte mbështetja e ZKA-së në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të saj në realizimin e qëndrueshëm të objektivave dhe të misionit në përputhje me Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) dhe rritjen e ndikimit të saj përmes komunikimit të intensifikuar me qytetarët, parlamentin dhe palët tjera të interesit.

Projekti "Bashkëpunimi për Zhvillim Institucional me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës 2020-2023" - Gjatë vitit 2021 ka vazhduar zbatimi i marrëveshja e bashkëpunimit bilateral në mes Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe ZKA-së. Projekti, ka për qëllim të mbështesë ZKA-në për të përvetësuar standardet e përditësuara dhe parimet e INTOSAI-t (IFPP) nëpërmjet dy objektivave: e para- forcimin e proceseve të brendshme organizative në ZKA, dhe e dyta- zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve për të kryer auditime të performancës me cilësi më të lartë, në mënyrë që ato të jenë sa më të dobishme për palët e interesit. Komiteti

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

Drejtues i Projektit në takimin e rregullt vjetor ka vlerësuar të arriturat dhe sfidat në zbatimin e aktiviteteve gjatë vitit 2021.

Takimet e AP-ve me homologë dhe vizita jashtë vendit - gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar disa vizita jashtë vendit dhe janë realizuar disa takime me homologë të ISA, si;



- AP-ja ka mbajtur takim virtual me Auditorin e Përgjithshëm të Çekisë dhe Presidentin e EUROSAT-t;
- AP-ja ka qëndruar për vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut, ku është nga homologu i tij Maksim Acevski;
- Me ftesë të Presidentit të Gjykatës Turke të Llogarive dhe EUROSAT-t, Seyit Ahmet BAŞ, AP-ja ka zhvilluar një vizitë pune në selinë e Gjykatës Turke të Llogarive në Ankara;

Foto 9. Auditori i Përgjithshëm në takim pune me AP-në e Polonisë.

- AP-ja është takuar me Auditorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Maqedonisë së Veriut për auditimin e fondeve IPA;
- AP-ja ka pritur në takim bilateral homologun e tij nga Polonia Marian Banaś me bashkëpunëtor; dhe
- AP-ja ka zhvilluar vizitë zyrtare në Kontrollin e Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, ku është pritur nga homologu z.Arben Shehu me bashkëpunëtor.



Foto 10. Auditori i Përgjithshëm në takim pune me Presidentit të Gjykatës Turke të Llogarive.


Vlen të theksohet se AP-ja ka qenë pjesëmarrës në konferenca dhe punëtori rajonale e ndërkombëtare, si;



Foto 11. Auditorja e Përgjithshme në takim pune me Kontrollin e Lartë të Shtetit Shqiptar.

- Seminarin ndërkombëtar “Potenciali i Inteligjencës Artificiale në parandalimin e korrupsionit dhe besueshmëria e matjes së korrupsionit”;
 - Punëtorinë e SIGMA-s për procesin e auditimit të shpenzimeve për Covid-19 nga perspektiva financiare dhe e pajtueshmërisë;
 - Kongresin e XI e EUROSAT-t
 - Konferencën “Pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit”.
 - Konferencën ndërkombëtare shkencore dhe praktike e INTOSAI-t
- Punëtorinë për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë në auditim
 - Punëtorinë “Përmirësimi i praktikave të auditimit në komuna”
 - Punëtorinë “Puna me parlamentet, në veçanti Komisionet e Llogarive Publike”
 - Punëtorinë “Auditimi i barazisë gjinore në Ballkani Perëndimor”
 - Projektin “Auditimi i reagimit ndaj Pandemisë COVID”

ZKA-ja ka kryer me kohë dhe relevancë të gjitha raportimet lidhur me Planin Kombëtar për zbatimin e MSA-së dhe Strategjisë për Reformën në Menaxhimin e Financave Publike, si dhe të gjitha obligimet tjera që lidhen me integrimin evropian.



Kapitulli V

Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2022

Kapitulli V

Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2022

1. Llogaridhënia e ZKA-s dhe sfidat

Pasqyrat Vjetore Financiare të ZKA-së janë dorëzuar dhe janë përfshirë në raportin e Qeverisë për Buxhetin e Kosovës për vitin 2021 në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Kuvendi i Kosovës është në proces të kontraktimit të një kompanie audituese të jashtëm për auditimin e PVF të ZKA-së.

ZKA-ja në kuptim të raportimit financiar dhe performancës, është llogaridhënëse sipas nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Sigurisht që ZKA gjatë vitit 2021 është ballafaquar me disa sfida në proceset audituese, por më kryesorët ishin;

- Pandemia covid'2019;
- Përvetësimi i metodologjisë së re audituese, si dhe
- Përvetësimi i Softueri për Sistemin Informativ i Teknologjisë së Auditimit (SITA).

2. Aktivitetet gjatë viti 2022

Plani strategjik 2018-2021 ka përfunduar dhe si rezultat është bërë vlerësimi i zbatimit të strategjisë paraprake (në raport më lartë është përshkruar në detaje). Mbi këtë bazë nga AP-ja është themeluar ekipi për hartimin e planit të ri strategjik dhe është duke punuar intensivisht për të finalizuar planin strategjik 2022-2025.

Po ashtu, Auditorja e Përgjithshme ka vlerësuar se është e rëndësishme që ZKA-ja t'i nënshtrohet vlerësimit të performancës sipas Kornizës së INTOSAI-t për Matjen e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA), dhe në tetor 2021 ka marrë vendimin për të kryer vetëvlerësimin e performancës së institucionit sipas kësaj kornize. Procesi i vlerësimit është duke u bërë në mënyrë të pavarur nga ekipi i ZKA-së, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të zyrtarëve të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t.

Ndërlidhur me këtë ZKA-ja është anëtarësuar në Task Forcën për auditim të komunave në kuadër të EUROSAI-t dhe gjatë viteve në vijim aspirojmë anëtarësimin në komisionet tjera profesionale. Gjatë vitit 2022 fokusi do të jetë në aktivitetet në vijim:

Qëllimi 1: Pavarësia, Standardet dhe Cilësia

- Inicimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore, në harmoni të plotë me INTOSAI P-10 që do të mundësonte aplikimin e metodologjisë për përzgjedhjen e auditimeve bazuar në rrezik;
- Përcjellja dhe adaptimi i standardeve të INTOSAI-t dhe përditësimi i doracakeve auditues dhe udhëzueseve në pajtim me SNISA dhe legjislacion në fuqi.
- Zhvillimi dhe avancimi i SITA-s, si dhe zhvillimin e kompetencave të personelit në aplikimin e tij.

Qëllimi 2: Forcimi i kapaciteteve dhe Burimet

- Të zhvilloi një sistem elektronik për menaxhimin e burimeve njerëzore në funksion të mbështetjes në procese të auditimit dhe qeverisjen korporatave;
- Ngritja dhe forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve profesionale të personelit për zbatimin e objektivave strategjike;
- Forcimi i mëtejshëm i kontroleve të brendshme institucionale.

Qëllimi 3: Imazhi dhe Ndikimi

- Rishikimi dhe adaptimi i kodit të etikës;
- Bashkëpunimi me OB për zbatimin e rekomandimeve dhe publikimi i bazës së të dhënave për zbatimin e rekomandimeve të auditimit;
- Komunikimi i rregullt me komisionet parlamentare, palët e jashtme, shoqërinë civile dhe mediat;
- Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e organizatave profesionale të auditimit INTOSAI dhe EUROSAL.

Shtojca I. AUDITIMET PËR SEZONIN 2020/21 DHE 2021/22

Në sezonin e auditimit 2020/2021 janë publikuar **131 raporte** të auditimit, si në vijim:

116 raporte të auditimit financiar me pajtueshmëri:

- Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës, të vitit 2020
- 52 Institucione të Nivelit Qendror
- 38 Komuna

12 Ndërmarrje Publike:

- Telekomi i Kosovës sh.a
- Posta e Kosovës sh.a
- Trainkos sh.a
- KRU Prishtina sh.a
- KRU Hidroregjioni Jugor sh.a
- KRU Drini i Bardhë sh.a
- KRU Hidromorava (për herë të parë)
- KRU Bifurkacioni (për herë të parë)
- Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a
- KRM Pastrimi sh.a,
- Hortikultura sh.a Prishtinë
- Ndërmarrje e re Energjetike(për herë të parë).

13 projekte të financuara nga donatorët:

- Zhvillimi rural dhe agrobujqësor (MBPZHR-BB)
- Ekonomia Digjitale në Kosovë (MEA-BB)
- Projekti për Përmirësimin e Sistemit Edukativ të Kosovës (MASHT-BB)
- Projekti për Shëndetësinë e Kosovës (MSH-BB)
- Eficienca e energjisë së ripërtëritshme (MZHE-BB)
- Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksportim (MTI-BB)
- Programi Mjedisor i Kosovës, PMK 2016-2020 (MMPH-SIDA)
- Përkrahja për përmirësimin e hartimit (zhvillimit) të politikave në Kosovë (ZKM-SIDA)
- Projekti i emergjencës COVID-19 në Kosovë (MSH-BB)

- Financimi i emergjencës pandemike në Kosovë (MSH-BB)
- Projekti i emergjencës COVID-19 në Kosovë (MPMS-BB)
- Pasuria e paluajtshme dhe infrastruktura gjeo-hapësinore (Agjencia Kadastrale e Kosovës) dhe Projekti “Komunat për rininë në Kosovë” (MAPL-BB)

13 auditime të performancës

- Vlera për para në ndërtimin e rrugëve rajonale dhe lokale
- Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare
- Furnizimi me barëra dhe materiale shëndetësore për t’iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19
- Optimizimi i resurseve njerëzore dhe pajisjeve teknike mjekësore për t’iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19
- Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet
- Mbledhja, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave komerciale
- Kontratat e centralizuara - Shërbimet e transportit ajror
- Vlera për para në prokurimet e centralizuara, pjesa e dytë
- Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale, për vitin 2019
- Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale SDC/DEMOS për vitin fiskal 2020
- Sistemi për menaxhimin informativ të lëndëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës
- Sistemet elektronike për menaxhimin e garantëve dhe subvencioneve në AZhB-MBPZHR
- Auditim i performancës –Vendimet lidhur me strukturën organizative dhe vendimet Alpex-KOSTT- Kuvendi i Kosovës.

2 Auditime të pajtueshmërisë

- Dhënia e pëlqimeve për ndërtim/shfrytëzim të pronës dhe marrëveshjeve për blerje të energjisë –KOSTT-Kuvendi i Kosovës,
- Shpenzimet për fondet e mbrojtjes juridike dhe mbështetjes financiare të personave të akuzuar potencial nga Dhomat e Specializuara- Ministria e Drejtësisë (raport jo për publikun).

Në sezonin e auditimit 2021/22, i cili ka filluar në shtator të vitit 2021, ZKA- ja planifikon të përfundojë **134** raporte të auditimit, si në vijim:

117 raporte të auditimit financiare dhe pajtueshmërisë:

- Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës të vitit 2020

- 52 Institucione të Nivelit Qendror
- 38 Komuna

12 Ndërmarrje publike:

- Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, sh.a
- Hekurudhat e Kosovës - TrainKos, sh.a
- KRU “Hidromorava” sh.a - Gjilan
- KRU “Hidroregjioni Jugor”, sh.a - Prizren
- KRU “Prishtina” sh.a - Prishtinë
- Ndërmarrja Publike Banesore - Prishtinë
- Telekom i Kosovës
- Posta e Kosovës
- KRM “Pastrimi”, sh. a - Prishtinë
- KRM “ Uniteti” sh.a - Mitrovicë
- Ngrohtorja Qendrore “Termokos” – Prishtinë
- NPH “Ibër - Lepenc” sh.a – Prishtinë

14 Projekte që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët

- Projekti për përmirësimin e sistemit edukativ në Kosovë (MASHT - BB)
- Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksport (MTI - BB)
- Eficienca e Energjisë së ripërtritshme (MZHE - BB)
- Eficienca e Energjisë së ripërtritshme (MZHE - BB)
- Zhvillimi Rural dhe Agrobujqësor (MBPZHR - BB)
- Ekonomia Digjitale në Kosovë (MEA – BB)
- Projekti për Shëndetësinë e Kosovës (MSH - BB)
- Projekti i emergjencës Covid-19 në Kosovë (MSH - BB)
- Financimi i emergjencës pandemike në Kosovë (MSH - BB)
- Projekti i emergjencës Covid-19 në Kosovë (MPMS - BB)
- Pasuria e paluajtshme & infrastruktura gjeoha-pësinore (Agjencia Kadastrale e Kosovës - BB)
- Projekti “Komunat për rininë në Kosovë” (MPL – BB))
- Përkrahja për përmirësimin e hartimit/zhvillimit të politikave në Kosovë (ZKM - SIDA)
- Programi Mjedisor i Kosovës – PMK 2016-2020 (MMPH - SIDA)

10 Temat e auditimeve të performancës

- Vlerësimi i nxënësve në testet kombëtare dhe ndërkombëtare- PISA
- Performanca financiare dhe operative e NP Trepça
- Sistemi i licencimit dhe monitorimit të hidrocentraleve
- Menaxhimi i fondeve publike Radio Televizioni i Kosovës
- KEK - Auditimi i kontratave të prokurimit
- KOSTT - Auditimi i Projekteve kapitale
- Bashkimi i Qytetit Ferizaj - Projekt kapital
- Sistemi i Gjendjes së Regjistrimit Civil
- Kontrollët e Informacionit në sistemin e pagave - PAYROLL
- Përcjellja e rekomandimeve në RVA 2020 për SIMFK në pjesën e TI-së.

3 Auditim me kërkesë (pajtueshmëri dhe performancë)

- Auditim i performancës –Vendimet lidhur me strukturën organizative dhe vendimet Alpex-KOSTT- Kuvendi i Kosovës.
- Dhënia e pëlqimeve për ndërtim/shfrytëzim të pronës dhe marrëveshjeve për blerje të energjisë –KOSTT-Kuvendi i Kosovës,
- Shpenzimet për fondet e mbrojtjes juridike dhe mbështetjes financiare të personave të akuzuar potencial nga Dhomat e Specializuara- Ministria e Drejtësisë (raport jo për publikun).

4 Auditimet e papërfunduara nga sezoni i kaluar

- Granti i Performancës Komunale – DEMOS.
- Menaxhimi i medikamenteve dhe materialeve tjera shëndetësore si përgjigje ndaj nevojave të pacientëve me Covid-19.
- Organizimi i resurseve njerëzore dhe teknike si përgjigje ndaj nevojave të pacientëve me Covid-19.
- Shërbimet e transportit ajror - Kontratë e centralizuar.

Shtojca II. PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZKA-SË PËR VITIN 2021



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE FINANCIAR BUREZUAR: 24.02.2022			
SHTYRI/PRILIDHJE/SHKËRIMET/REKORDE/REKORDE/REKORDE/REKORDE			
Niveli Org. Org. Jedin. Org. Unit.	Shtif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Fashove Br. Stranota No. Pages
01	402	356	23



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nationalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

- Për: z. Ahmet Ismaili, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
- Kopje: Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, Kuvendi i Kosovës
Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, Kuvendi i Kosovës
- Lënda: Pasqyrat vjetore financiare - 2021
- Datë: 24.02.2022

I nderuar, z. Ismaili,

Ju lutem gjeni të bashkangjitura Pasqyrat Vjetore Financiare të korigjuara për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, të përgatitura nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës.

Korigjimi ka të bëjë me shpalosjen e projeksioneve e të hyrave jo-tatimore të përgatitura nga Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Saktësisht, korigjimi është realizuar në tabelën e dytë dhe të katërt, respektivisht në nenet 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit dhe 14.6 - Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale e buxhetit.

Për shkak të rumbullaksimit të shumave të përgjithshme, korigjim është bërë edhe në tabelat sipas nenit 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit, neni 14.6 - Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale e buxhetit, shenimi 2 - Paga dhe roga, dhe Shënimi 4 - Shpenzimet komunale

Sinqerisht,




Vlora Spanca
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
PËRVENDIMOR SHENESUAR PËR SHËRIMIN E DOKUMENTIT (TË BASHKËSHKRUARIT)			
7 h. 02 2021			
Nr. e Org. Org. Jecim. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr i faqeve Br. Stranica No. Pages
01	402	356	22

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021



Neni 12
DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: AHMET ISMAILI, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Nga: VLORA SPANCA, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)

ADEM SYLEJMANI, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021 dhe është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2021.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrë të duhur.
- Të gjitha huatë e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Data: 24/02/2022

(Nënshkrimi i ZKA)



Data: 24/02/2022

(Nënshkrimi i ZKF)

Neni 13

Pasqyra e pranimëve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimëve dhe pagesave të parave të gatshme për Zyren Kombëtare të Auditimit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2021

Shënimet	2021		2020		2019	
	Llogaria e Veime e Theasurit		Llogaria e Veime e Theasurit		Llogaria e Veime e Theasurit	
	BK	BK	BK	BK	BK	BK
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
BURIMET E FONDEVE - PRANIMET						
Granti Qeveritar	2,750	3,026	2,753			
Te hyrat vetanake		15	20			
Te hyrat nga AKP			122			
Grantet e përcaktuara të donatorëve			95			
Tjera/Donacion						
Gjithsej	2,750	3,041	2,990			
SHFRYTËZIMI I FONDEVE - PAGESAT						
Operacionet						
Paga dhe rroga	2,192	2,216	2,125			
Mallra dhe Shërbime	475	523	710			
Shërbime Komunale	34	30	33			
	2,701	2,769	2,868			
Shpenzime Kapitale	49	272	122			
	49	272	122			
Tjera/Donacion						
Gjithsej	2,750	3,041	2,990			

Neni 14
Raporti i ekzekutimit të buxhetit
Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore aktuale për Zyrën Kombëtare të Auditimit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2021

	2021		2020		2019	
	Realizimi A € '000	Buxheti Final B € '000	Buxheti Efektiv C € '000	Variance D=A-B € '000	Realizimi E € '000	Realizimi F € '000
Shënimet shprehse						
HVRJA E PARASË SË GATSHME						
Grantet e përcaktuara të donatorëve						
Te hyrat jo tatimore	39	18	40	21	20	114
Gjithshëj pranimet	39	18	40	21	20	142
DALJA E PARASË SË GATSHME						
Paga dhe rrogat	2,192	2,192	2,088	0	2,216	2,125
Mallra dhe shërbime	475	510	605	-35	523	710
Shërbime komunale	34	36	50	-2	30	33
Shpenzime kapitale	49	53	53	-4	272	122
Gjithshëj pagesat	2,750	2,791	2,796	-41	3,041	2,990

Neni 15

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

3

Shënimi 1

1 Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007.

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Entiteti i sektorit publik, Zyra Kombëtare e Auditimit ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007.

Sipas LMFPF të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka përcaktuar Auditorin e Përgjithshëm si institucion i pavarur dhe më i larti, i kontrollit ekonomik e financiar në vend. Kompetencat themelore të Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar me Kushtetutë dhe janë definuar më tej me ligjin e veçantë Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2016. Sipas legjislacionit në fuqi, Auditori i Përgjithshëm ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij. Ai është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së. ZKA është institucion i pavarur kushtetues me mandat për kryerjen e auditimit të jashtëm në të gjitha organizatat buxhetore dhe në subjektet tjera shtetërore.

Vizioni i ZKA-së

Institucion i besueshëm i auditimit, që përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve.

Misioni i ZKA-së

Përmes auditimeve cilësore të fuqizojë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Vlerat e ZKA-së

- Pavarësia;
- Profesionalizmi;
- Integriteti; dhe
- Transparenca

1.2 Pagesat nga palët e treta

Në zbatim të SNKSP 2017 pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.3 Shumat raportuese

Shumat raportuese nga neni:

13 deri te neni 15 janë në '000 (mijë) Euro (€),

16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

1.4 Valuta raportuese

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€).

1.5 Data e autorizimit

